



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qëveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINË I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

STRATEGJIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN
E MBETURINAVE 2013 - 2022

Prishtinë, 2013

Hartues i Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

VIZIONI: 2013 - 2022

Reduktimi



Ripërdorimi



Riciklimi



Prodhimi i energjisë



Deponimi

Fjala e ministrit

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave do të ketë rol kyç për të arritur një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave. Përmes strategjisë synojmë të vendosim politikat që ofrojnë një kornizë të planifikimit e cila për menaxhimin e mbeturinave do të përcaktojë caqet sipas Planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe planeve lokale që janë instrumentet më të rëndësishme për zbatimin e politikave dhe arritjen objektivave për menaxhimin e mbeturinave, si komponentë e zhvillimit ekonomik.

Çdo ditë, në shtëpi, në biznese dhe industri të ndryshme krijohen mbeturina, të cilat shkaktojnë ndikime të dëmshme në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Për menaxhimin e duhur të tyre do të duhet angazhim i çdo njërit prej nesh. Si individë dhe institucione jemi duke bërë përpjekje dhe jemi gjithnjë e më të vetëdijshëm për mundësitë tona dhe nevojën për t'u kujdesur për resurset e çmuara dhe për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Po jetojmë në një kohë të ndryshimeve të vullshme dhe për menaxhimin e mbeturinave, ne po synojmë për ti zbatuar përvojat e mira të shteteve rajonit dhe gjithashtu edhe të shteteve të BE-së. Deri më tani kemi arritur të hartojmë legjislacionin për mbeturinat i cili mjaft mirë është përfaqësuar me legjislacionin e BE-së.

Tani duhet bërë përpjekje për zbatimin e ligjeve dhe monitorimin e gjendjes për menaxhimin e mbeturinave. Kryesisht duhet fokusuar për zbatimin e parimit për menaxhimin e mbeturinave sipas prioritetit, që dmth. sa më shumë ti shmangemi krijimit të mbeturinave, pastaj duhet synuar në zhvillimin projekteve për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave sepse në këtë mënyrë do të reduktojmë hapësirat e nevojshme për deponim të mbeturinave dhe njëkohësisht do të reduktojmë ndotjen e mjedisit nga mbeturinat.

Në Kosovë ka ende shumë për tu bërë lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Ne duhet të vazhdojmë pastrimin e mbeturinave, parandalimin dhe reduktimin e sasisë mbeturinave. Mbi të gjitha, ne duhet të pranojmë dhe ta dijim se çdo gjë që ne e hedhim si mbeturinë, ajo është një mall i cili ka një vlerë, një vlerë që ne duhet të përpiqemi për ta ruajtur dhe ta përdorim përsëri kudo që të jetë e mundur.

Zgjidhjet e problemeve për menaxhimin e mbeturinave kërkojnë përfshirjen e shumë pjesëmarrësve dhe planifikim koherent për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve të pjesëmarrësve.

Unë, besoj se përmes kësaj Strategjie do të vendosen politika reale, objektiva ambicioze dhe të qëndrueshme dhe jepen sinjale të qarta për të bërë plane dhe të merren vendime që të investohet për menaxhimin e drejtë dhe efikas të mbeturinave, me synim për të siguruar mjedis të pastër për gjeneratat e ardhshme.

PËRMBAJTJA	
HYRJE.....	8
1. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË.....	9
1.1 Objektivat dhe fushëveprimi i strategjisë.....	9
1.2 Parimet themelore.....	10
1.3 Korniza Ligjore	11
1.4 Trendët evropianë në menaxhimin e mbeturinave.....	12
1.5 Menaxhimi i mbeturinave- vizioni dhe prioritet	14
2. GJENDJA E TANISHME.....	17
2.1 Vlerësimi i gjendjes, problemet dhe pengesat.....	17
2.2 Pjesëmarrësit në menaxhimin e mbeturinave.....	21
2.3 Cikli i mbeturinave.....	20
2.4 Procedurat e menaxhimit të mbeturinave.....	20
2.5 Objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave.....	34
2.6 Sanimi i deponive dhe hot spoteve.....	35
3. MASAT DHE OBJEKTIVAT	35
3.1 Masat për realizimin e objektivave të strategjisë.....	36
3.2 Objektivat në afat kohorë për administrim të mbeturinave.....	37
3.3 Masat për realizimin e objektivave.....	39
4. KAHJET E ZHVILLIMIT.....	44
4.1 Koncepti i menaxhimit të mbeturinave	44
4.2 Aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave të veçanta.....	45
5. VLERËSIMI I INVESTIMEVE DHE BURIMI I MJETËVE FINANCIARE.....	52
6. PËRFUNDIMET.....	60

LISTA E TABELAVE

Tab.1. Sasia e mbeturinave në tri vendet e BE-së dhe në Republikën e Kosovës.....	14
Tabela2. Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave në tri vendet e BE-së dhe në Republikën e Kosovë	18
Tab.2-a. Deponimin e mbeturinave të ngurta komunale në Bashkimin Evropian	15
Tab.3. Çmimet e përpunimi termik dhe deponimit të mbeturinave komunale në disa shtete të Evropës dhe në Kosove	18
Tabela 4. Sasia ditore dhe vjetore e mbeturinave për banor.....	23
Tab.4-a. Perberja fizike e mbeturinave komuna	20
Tab.4-b. Analiza e synuar e mbeturinave	21
Tab.4-c. Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të deponuara në deponitë të kontrolluara dhe ato ilegale gjatë vitit 2008, 2009 dhe 2010.....	22
Tab.5. Deponitë industriale të Trepçës.....	23
Harta e Republikës së Kosovës.....	25
Tab.5-a. Përbërja e gomave.....	25
Tab.5-b. Shkarkimet e ujërave të zeza në Kosovë.....	27
Tab.6. Deponitë Sanitare në Republikën e Kosovës.....	30
Tab.7. Objektivat për realizimin e qëllimeve strategjike.....	33
Tab.8. Objektivat për riciklim dhe ripërdorim.....	33
Tab.8-a. Ndarja e materialeve për riciklim.....	38
Tab.8-b. Objektivat nga legjislacioni i BE-s për riciklimin trajtimin e mbeturinave.....	39
Tab.9. Krahasimi i përafërt i mënyrave relative dhe të opsioneve të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave	43
Tab.10. Sasia e mbeturinave spitalore të gjeneruara në Republikën e Kosovës	
Tab.11. Realizimi i projekteve sipas investime dhe të agjencive udhëheqëse për zbatim dhe koston e projekteve.....	57
Tab.12. Shpërndarja e investimeve për dhjetë (10) vite dhe dy (2) periudha.....	59

Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në bashkëpunim me të apostrofuariat në:

Falenderim,

Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave është dokumenti i hartuar për her të parë në Republikën e Kosovës dhe përfshinë periudhën kohore 2013-2022. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i falënderon të gjithë pjesmarrsit që kontribuan në përgatitjen e kësaj Strategjie, përfshirë KE, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Menaxhimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme, Përfaqësuesit e komunave të Republikës së Kosovës, Ndërmarrjen “Trepça”, Korporatën Energjetike të Kosovës, Kompanitë Regjionale Mbeturinave, Doganën e Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Universitetin Humboldt nga Berlini, KDMK, Asociacioni i Komunave të Kosovës, OJQ Lulebora, Eko-Trepça, REC, GTZ-zyra në Prishtinë, New Co Ferronikeli, Sharrcem, ZRRUM, AKPM, AMMK dhe në fund punën e palodhshme të zyrtarëve të MMPH-së.

SHKURTESAT

APK	Agjencioni per Privatizim i Kosovës
AKPM	Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale
AMMK	Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
BAT	Best Available Technology (Teknologjia më e Mirë në Dispozicion)
BE	Bashkimi Evropian
Cd	Kadmiumi
DANIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Danez për Zhvillim
GIZ	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
JICA	Agjensioni për Cooperim Internacional i Japonisë
IPPC	Integratet Pollution Prevention and Control
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë
KMDK-	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
MMPH	Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSH	Ministra e Shëndetësisë
Mton	Milion ton
Pb	Plumbi
PBB	Poli Bifenil Bromur
PCB	Poli Klorur Bifenil
PCT	Poli Klorur Trefenil
PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
TC	Termocentral
TC-A	Termocentrali A
TC-B	Termocentrali B
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
BK	Bugjeti i Republikës së Kosovës

HYRJE

Gjendja e menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës aktualisht është mjaft e palakmueshme. Nga Raporti i gjendjes së mjedisit dhe Raporti i gjendjes së mbeturinave rezulton se sasia e mbeturinave në Kosovë është gjithnjë në rritje dhe menaxhimi i tyre, përfshirë infrastrukturën nuk është në nivelin e duhur. Strategjia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022 parasheh objektivat dhe masat për përmirësimin e gjendjes dhe menaxhimin e mbeturinave. Neni 8 dhe 9 i Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 obligon hartimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (tekstin e metejme Startegjia) e cila përmban përshkrimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave, qëllimet themelore dhe masat për menaxhimin e mbeturinave, masat që duhet të ndërmerren për menaxhimin e mbeturinave të parrezikshme dhe të rrezikshme, përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjen ose deponimin e sigurt të mbeturinave, sigurimin e masave dhe standardeve teknike, prodhuese dhe administrative për arritjen e qëllimeve për menaxhimin e mbeturinave, etj.

Strategjinë e harton MMPH në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet tjera kompetente, për periudhë kohore dhjetë vjeçare dhe me propozim të ministrit miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia rishqyrtohet së paku çdo 5 vite, dhe në të bazohet Plani për menaxhimin e mbeturinave i cili hartohet për 5 vite.

Mungesa e sistemit funksional për menaxhimin e mbeturinave, ka pasur efekte negative në mjedis; ujë, ajër, tokë dhe shëndetin e njeriu. Nga mbeturinat duke përfshirë edhe mbeturinat e rrezikshme që janë akumuluar në ambientet e kompanive të ndryshme prodhuese veçanërisht, të rrezikuara janë ujërat nëntokësorë.

Sasi të mëdha të kimikateve, mbeturina industriale dhe minerare me përmbajtje të lartë të metaleve të rënda janë trashëguar nga industria Kosovare e paraluftës të cilat ende nuk janë trajtuar. Vet fakti se teknologjitë përpunuese ishin jo efikase që nuk kanë mundësuar shfrytëzimin e mjaftueshëm të lëndës së parë, ka bërë që sasia e mbeturinave minerare të deponuara të jetë më i madh të cilat aktualisht shkaktojnë dëme të mëdha në mjedisore duke ndotur ajrin, tokën, ujerat sipërfaqësor dhe nëntokësor. Për sanimin e tyre nevojiten studime, mjete financiare dhe pajisje teknologjike.

Sasia e mallrave ushqimore të importuara, makineri dhe pajisje të vjetra ka bërë që Kosova të ketë sasi të mëdha të mbeturinave. Ndihamat emergjente në periudhën e pas luftës kanë sjell sasi të konsiderueshme të barnave, pesticideve dhe llojeve tjera të materialeve shpenzuese të cilave ju ka kaluar afati dhe janë shndërruar në mbeturina të rrezikshme. Një zgjidhje efikase dhe e shpejt për menaxhimin e mbeturinave është i nevojshëm jo vetëm për të ruajtur shëndetin e njeriut por edhe mjedisin në përgjithësi.

Ndotja e mjedisit nga menaxhimi jo i drejtë i mbeturinave është ndër problemet më të mëdha në kuadër të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë. Përveç nevojës për të harmonizuar ligjet vendore me ato të BE- së, vendi duhet ndryshuar situatën aktuale në të cilën mungon zbatimi i ligjeve dhe i politikave të përcaktuara. Institucionet ende nuk kanë kompetencat qartë të definuara, kështu që kjo strategji synon ndarjen e kompetencave, përcaktimin e objektivave kryesore, masat dhe projektet të cilat për një periudhë dhjet vjeçare Republika e Kosovës duhet ti realizojë.

Me këtë strategji dhe planin e veprimit për mbeturina, synohet të përmirësohet gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave duke ndërtuar konceptin e drejtë dhe modern për menaxhimin e mbeturinave.

1. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

1.1 Objektivat dhe fushëveprimi i strategjisë

Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i një kornize masash brenda së cilës në Republikën e Kosovës do të duhej të zvogëloj sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen dhe ngritjen e sistemit të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave.

Strategjia për administrimin e mbeturinave përcakton orientimet dhe qëllimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën dhjetëvjeçare (2013-2022), në harmoni me legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave dhe mundësit ekonomike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Zhvillimin e infrastrukturës për ngritjen e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim - Ripërdorim - Riciklim- Djegie - Deponim) pra duke krijuar kushtet për një funksionim efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit të mbeturinave,(përmirësimi i sistemit aktual, zgjerimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për depnimin e mbeturinave).
- Edukimi i publikut, trajnimi i zyrtarëve,
- Kompletimi i legjislacionit dhe udhëzuesve për mbeturinat;

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, do të zbatohen masat si në vijim:

- Përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme;
- Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme të trashëguara, që janë në kompetencë të Qeverisë.
- Inkurajimi i përdorimit të instrumenteve ekonomike;
- Ngritja e përgjegjësisë së prodhuesit të produkteve dhe mbeturinat nga produktet.
- Inkurajimi i konsumatorit në favor të konsumit të produkteve të pastërta dhe proceseve të krijimit sa më të vogël të mbeturinave.

Strategjia është dokument që dedikohet nivelit qendror dhe lokal si dhe sektorëve të ndryshëm qeveritar dhe joqeveritar duke përfshirë sektorin e ujërave, minierave, shëndetësisë, veterinarisë, planifikimit hapësinorë, ndërtimtarisë dhe industrisë etj.

Duke u nisur nga vlerësimi i situatës aktuale, si dhe vizioni për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në vendin tonë, Strategjia do të përcaktoj objektivat dhe masat që kanë për qëllim zbatimin e tyre në menaxhimin e mbeturinave deri në vitin 2022.

1.2 Parimet themelore

Me këtë dokument do të rregullohet menaxhimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave në territorin e Republikës së Kosovës, që nga krijimi i tyre deri te deponimi përfundimtar. Qëllimi kryesor është formimi i një sistemi të qëndrueshëm në menaxhimin e mbeturinave i cili do të jetë në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së dhe legjislacionin vendor të mbeturinave.

a. Parimi i menaxhimit të mbeturinave sipas prioritetit:

- zvogëlimi i prodhimit të mbeturinave dhe zvogëlimi i rrezikut prej tyre;
- kur zvogëlimi i sasisë së mbeturinave në burim nuk është i mundur atëherë mbeturina duhet të ripërdoret apo riciklohet;
- përfitimi i energjisë nga mbeturinat
- mbeturina që nuk mund të ripërdoren në mënyrë racionale, duhet të deponohen në mënyrë sa më të pranueshme për mjedisin.

b. Shfrytëzimi i teknologjisë më të mirë të mundshme në raport me shpenzimet dhe pranueshmërinë mjedisore

Emetimet nga objektet për trajtimin e mbeturinave dhe deponitë, duhet zvogëluar sa më shumë që është e mundur në mënyrën më efikase nga aspekti teknik dhe ekonomik. Zvogëlimi i emetimeve bëhet me përdorimin e teknologjive të përshtatshme sipas standardeve të BE (makineri dhe pajisje moderne për trajtimin dhe mirëmbajtjen e deponive).

c. Përgjegjësia e prodhuesit

Prodhuesit, nga prodhuesit e të cilëve krijohet mbeturina janë përgjegjës për zgjedhjen e teknikave më të përshtatshme dhe më të pranueshme për mjedisin.

Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave. Për menaxhimin e mbeturinave, përgjegjësinë e prodhuesit e mbajnë edhe operatorët e tjerë.

d. Pavarësia dhe afërsia

Me qëllim të zvogëlimit të kostos për menaxhimin e mbeturinave duhet të krijohet një rrjet i integruar i objekteve dhe instalimeve për trajtim, riciklim dhe deponim të mbeturinave, në përputhje të plotë me kërkesat nga legjislacioni për mbeturina të Republikës së Kosovës. Në raste të veçanta nëse trajtimi nuk mund të bëhet në vend, ato duhet të dërgohen për trajtim jashtë vendit.

e. Mbështetja e aktiviteteve që favorizojnë përafrimin dhe pranimin në BE

Me qëllim të harmonizimit të politikave mjedisore me të BE dhe përshtatjen e legjislacionit me Acquis Communautaire në fushën e menaxhimit të mbeturinave duhet të zhvillohen aktivitete në atë mënyrë që të zgjedhën metoda më të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave.

f. Evitimi i mangësive në politikat dhe praktikën e deritanishme në menaxhimin e mbeturinave

Bazuar në mangësitë e identifikuar, është shumë e rëndësishme që ti ndryshojmë politikat dhe praktikat në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ti kontrollojmë dhe përmirësojmë rregulloret dhe procedurat, respektim i rreptë i parimeve dhe standardeve, si dhe themelimin e rrjetit të objekteve, pajisjeve të nevojshme për të pasur një sistem më efikas të menaxhimit të mbeturinave.

g. Ndotësi paguan

Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre.

h. E drejta e qasjes në informacione, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

Secila palë e interesuar, që jeton në Republikën e Kosovës ka të drejtë qasjeje në informacione dhe vendimmarrje.

i. Roli në edukim dhe arsimimit për vetëdijësim

Duhet ti jepet rendësi edukimit dhe arsimimit të qytetareve përmes organizimit të aktiviteteve shoqërore dhe publike në forma të ndryshme, si që janë krijimi i programeve të trajnimit për bërjen e aktiviteteve për rritjen e vetëdijësimit të komunitetit.

j. Përgatitja për tregun e hapur

Duhet inkurajuar menaxhimin e segmenteve tjera të shoqërisë duke përdorur instrumente ekonomike dhe forma tjera në përkrahje të menaxhimit të mbeturinave në përputhshmëri me kërkesat për ruajtjen e mjedisit dhe kornizën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

k. Qasja hap pas hapi

Duhet të përmirësohet gjendja e menaxhimit të mbeturinave, përmes marrjes së masave hap pas hapi në faza të caktuara, përmes mbikëqyrjes dhe vërtetimit të kryerjes së aktiviteteve dhe shërbimeve cilësore.

1.3 Korniza Ligjore

Republika e Kosovës ndodhet në fazën e hartimit dhe rishqyrtimit intensiv të legjislacionit për administrim të mbeturinave që mbështetën në direktiva dhe rregullore të BE-së.

Strategjia bazën ligjore e siguron nga Ligji për Mbeturina nr. 04/L-060. Strategjia është përgatitur në përputhje me aktivitetet e planifikuara nga autoritetet e menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Ligji për Mbeturinat paraqet aktin themelor dhe i përcakton rregullat e përgjithshme të cilat zbatohen për çështje themelore në lidhje me mbeturinat.

Deri më tani përveç Ligjit për Mbeturina janë nxjerrë edhe Udhëzime Administrative të paraparë me këtë ligj. Me sektorin e mbeturinave janë të lidhur ngushtë edhe: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Ndërtimin, Ligji për Vlerësim Strategjik Mjedisor, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujërat, Ligji për Kimikate, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Parandalim dhe Kontroll të Integruara të Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e

Natyres, Ligji për Ndërmarrjet Publike, Ligji mbi Vetëqeverisje Lokale, Ligji mbi veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave, etj.

1.4 Trendët evropianë në menaxhimin e mbeturinave

Politika e BE-së për Menaxhimin e Mbeturinave është përfshir në Rezolutën e Këshillit Evropian në Strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave (97/C76/01), e cila është e bazuar në Direktivën për mbeturina (74/442/EEC), e ndryshuar nga direktiva (2006/12/EC) dhe gjithashtu me direktivën 2008/98 EC, si dhe në rregulloret tjera të BE për menaxhimin e mbeturinave.

Në BE bëhen përpjekje që të respektohen parimet e mëposhtme:

- *Miratimi i definicionit të përbashkët të mbeturinave në të gjitha vendet anëtare*

Përkufizimi i mbeturinave të përfshira në nenin 3, pika 1 të Direktivës për mbeturina 2008/98 -EC është i detyrueshëm për të gjitha vendet anëtare dhe duhet të zbatohen për të gjitha mbeturinat pa marrë parasysh nëse janë të destinuar për asgjësim ose për ripërdorim. Përveç kësaj, lista e mbeturinave që figurojnë në Listën Evropiane të mbeturinave (i njohur më parë si: Katalogut Evropian për Mbeturina) siguron një terminologji të përbashkët për lloje të ndryshme të mbeturinave.

- *Inkurajimi i prodhimit të pastër dhe përdorimit të produkteve të pastra*

Inkurajim në sferën e zhvillimit të prodhimit të pastër dhe përdorimi i produkteve të pastra i cili do të ulë efektin negativ në mjedis. Kjo mund të arrihet me përdorim më eficient të burimeve ose resurseve, si dhe nga zvoglimi i sasisë së emetimeve gjatë prodhimit të produkteve dhe menaxhimit të mbeturinave.

- *Inkurajimi i përdorimit të instrumenteve ekonomike*

Qëllimi i kësaj qasje është të ndikoj në mbrojtjen e mjedisit përmes mekanizmave të tregut, si:

- aplikimi i tarifave për e krijimin, mbledhjen, trajtim, ruajtje dhe deponim të mbeturinave;
- subvencionimi për riciklimin e mbeturinave,
- detyrimet e importit për mbeturina.

- *Rregullimi i transportit të mbeturinave*

Sistemi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të mbeturinave duhet të jetë i rregulluar, si dhe vendet anëtare të BE duhet të jenë të detyruara të ngrejë në nivel kombëtar, mbikëqyrjen dhe sistemin e kontrollit për të siguruar nivelin e lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, dhe për të siguruar zbatimin e parimet për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara si në Direktivat e BE-së dhe Regulloren e 1013/2006/EC për qarkullimin ndërkufitarë të mbeturinave të rrezikshme .

- *Mbrojtja e mjedisit dhe tregu i brendshëm*

Detyrimet nga legjislacioni mjedisor janë për të krijuar një ekuilibër të duhur në mes nevojës për të siguruar nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe nevojës për të pasur rregullore që të sigurojë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm. Kështu subjektet ekonomike janë lejuar për të vepruar në kuadër të BE-së, ndërsa në të njëjtën kohë një fushë e harmonizuar e veprimit është e specifikuar për mbeturinat përmes krijimit të rregullave të përbashkëta. Prandaj, dëshirat legjitime të vendeve anëtare janë që të respektohen plotësisht përcaktimi dhe zbatimi i politikave për menaxhimin e mbeturinave dhe masave në nivel kombëtar. Kjo veçanërisht ka të bëjë me transportimin e rregullt të mbeturinave. Tregu i brendshëm në një masë është vetë-rregulluar, varësisht nga kërkesat e tregut të lirë. Në Kosovë funksionojnë 36 kompani private që kryesisht merren me mbledhjen, grumbulimin, ndarjen në lloje, përpunimin fizik dhe eksportimin e mbeturinave të metalit, letrës dhe plastikës.

Pozicioni i Komisionit Evropian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, si dhe iniciativa e re lidhur me mbeturinat për dekadën e parë të shekullit XXI, janë të përfshira në planin e gjashtë të veprimit në mjedis- *Mjedis 2010: "E Ardhmja Jonë, Zgjedhja Jonë"*, e cila është miratuar në vitin 2001.

Edhe pse nuk devijon nga qasja aktuale, programi i vë një theks të veçantë nevojës për të bërë përmirësime të rëndësishme në vendet anëtare në lidhje me zbatimin e masave ekzistuese. Pasi që autoritetet lokale shpesh janë ato që mbajnë barrën e zbatimit të legjislacionit të BE-së në fushën e mbeturinave.

Për vendet kandidate, është theksuar se konsumi i lartë dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës, me gjasë të madhe do të shtojnë një barrë shtesë për sistemin aktual të menaxhimit të mbeturinave dhe për infrastrukturën komunale. Kjo është arsyeja që do t'i jepet prioritet jo vetëm për përmirësimin e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, por edhe për investimet në iniciativat që kanë për qëllim zvogëlimin e mbeturinave, riciklimin, dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Objektivat e politikës së menaxhimit të mbeturinave të BE-së, sipas Programit, janë:

- Zvogëlimi i krijimit të mbeturinave në raport me rritjen ekonomike dhe arritja e zvogëlimit të rëndësishëm në vëllimin të mbeturinave të krijuara.
- Për mbeturinat që krijohen vazhdimisht, të arrihet që:
 - mbeturinat të jenë sa më pakë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
 - Mbeturinat të futen në treg për përfitim ekonomik, sidomos nga procesi i riciklimit, ose janë kthyer në mjedis në formë të dobishme (p.sh. kompostim) ose mbeturinat janë bërë të padëmshme.
 - sasia e mbeturinave për deponim të zvogëlohet në vlerë minimale dhe deponimi të bëhet në mënyrë të sigurt,
 - mbeturina të trajtohen sa me afër të jetë e mundur nga vendi ku është prodhuar.

Për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme sipas programit të BE-së duhet bërë:

- Identifikimin e materieve dhe mbeturinave të rrezikshme të krijuara nga sektor të ndryshëm;
- Përcaktimi i objektivave dhe prioriteteve për parandalimin e mbeturinave;
- Inkurajimi i përdorimit të instrumenteve ekonomike;
- Implementimi i përgjegjësive së prodhuesve për prodhimet e tyre;
- Favorizimi i kërkesës së konsumatorëve në favor të produkteve dhe proceseve që të krijojnë më pak mbeturina.

Treguesit e menaxhimit të mbeturinave për disa vende të zgjedhura të BE-së dhe për Republikën e Kosovës janë paraqitur në tabelat 1, 2 dhe 3.

Tabela 1. Sasia e mbeturinave në tri shtete të BE-së dhe në Republikën e Kosovës

	Austria	Danimarka	Sllovenia	Kroacia	Kosova
Numri i banorëve (mil.)	8.1	5.4	2	4.45	2.3
Sasia totale e mbeturinave (mil.ton)	48.6	13.0	8.4	12.6	2.504
Sasia e mbeturinave komunale (mil.ton/për vit)	3.1	3.1	0.8	1.2	~ 0,4
Sasia vjetore e mbeturinave komunale për një banor (kg)	383	574	400	270	192

Tabela 2. Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave në disa shtete të BE-së, Kroaci dhe Kosovë

	Austria	Danimarka	Sllovenia	Kroacia	Kosova
Mbeturinat e grumbulluara për riciklim	34.3%	14%	10%	10%	9%
Mbeturinat e grumbulluara për trajtim biologjik	21.7%	-	12%	1%	1%
Mbeturinat e grumbulluara për djegieje	16 %	81%	-	-	-
Mbeturinat e grumbulluara për deponim	27.2 %	5%	73%	89%	90%

Burimi: Të dhënat në tabelat 1 dhe 2 për Kosovën janë të bazuara në Raportin për gjendjen e mbeturinave në Kosovë për vitin 2008.

Për shkak të besueshmërisë në përgjithësi të dobët dhe krahasueshmërinë e statistikave të mbeturinave, shifrat e prezantuara këtu janë thjesht sa për ti krahasuar.

Tabela 2-a: Deponimi i mbeturinave komunale të ngurta në Bashkësinë Evropiane

Shteti	Sasia e përgjithsme e	% Deponuar	% të djegura
---------------	------------------------------	-------------------	---------------------

	mbeturinave të ngurta komunale (M. ton)		
Austria ¹	2.78 (1996)	32	16
Belgium ²	4.00 (1997)	42	35
Denmark ³	2.77 (1996)	15	56
Finland ⁴	3.10 (1990)	77	2
France ²	33.00 (1997)	60	30
Germany ²	40.00 (1993)	62	28
Greece ⁴	3.20 (1992)	93	0
Ireland ⁵	1.85 (1995)	100	0
Italy ²	26.0 (1997)	85	8
Luxembourg ⁵	0.30 (1995)	24	48
Portugal ⁵	3.60 (1995)	86	0
Spain ⁶	15.20 (1997)	85	8
Sweden ²	3.60 (1996)	31	39
The Netherlands ²	14.20 (1997)	69	20
United Kingdom	40.00 (1997) ⁷	858	88
European Union	133.55 (1996)⁹	71	18
Kosova	0.38471(2010)	90	0

A report prepared by IPTS , the incineration of waste in Europe: issues and perspectives (1999)

1 Burimi: Austrian Environment Ministry, January 22, 1999

2 Burimi: Energy from waste plants: databook of European sites, Juniper Consultancy, November 1997; for NL, different statistics co-exist (e.g. 52% landfilled and 31% incinerated)

3 Burimi: Ministry of Environment and Energy, DK

4 Estimations adapted from Eurostat, 1997

5 Burimi: European Environmental Agency, Waste Topic Center, 1998

6 Burimi: Mr Martinez de Hurtado Gil, Spanish Ministry of the Environment, 20 January, 1999

7 Burimi: see footnote 2; estimated 25 Mt from household waste only

8 ENDS Daily, 1998

9 Data on MSW production from APME, 1998, not the sum of the column (193.23 Mt); % calculated from the table.

Tabela 3. Çmimet e përpunimit, djegies në furra dhe deponimit të mbeturinave komunale në disa shtete të Evropës dhe në Kosove.

Shteti	Kostoja e përpunim tërmik	Kostoja e deponimit
	€/t	€/t
Austria	100-250	60-130
Çekia	36-71	32
Danimarka	55-105	60-110
Italia	70-90	90-110
Hungaria	45	10-20
Holanda	80-150	110-130
Gjermania	50-400	15-200
Portugalia	26-98	125-386
Spanja	34-59	
Suedia	30-60	50-100


Zvicra	127	20-60
Kosova	-	6-7

1.5 Menaxhimi i mbeturinave- vizioni dhe prioritetet

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës me prioritet të veçantë është fokusuar edhe në Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit.

Vizioni për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës është sipas konceptit - të krijohet sa më pak mbeturina për deponim.

Për realizimin e këtij koncepti të bazuar në hierarkinë e menaxhimit të mbeturinave duhet që të zvogëlohet krijimi i mbeturinave që në burim si dhe rrezikshmëria prej tyre, të zbatohet riciklimi dhe trajtimi (mekanik, biologjik, energjetik) deri te ripërdorimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave. Për tu arritur kjo, duhet që vazhdimisht të punohet në edukimin dhe përgatitjen e secilit pjesëmarrës për menaxhimin e mbeturinave.



Për zbatimin e strategjisë parashifën prioritetet si në vijim:

- harmonizimi i legjislacionit vendore me atë të BE-së dhe sigurimi i zbatimit të tij;
- arsimimi dhe trajnimi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave;
- rritja e vetëdijimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe për menaxhimin e mbeturinave
- zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave në vend burim;
- ngritjen e shkallës së përqindjes së mbledhjes dhe deponimin e kontrolluar të mbeturinave;
- rehabilitimin e vendeve të ndotura nga mbeturinat;
- parandalimi i sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme nga ndikimi negativ i mbeturinave në mjedis,
- zvogëlimi i emisioneve në ujë, ajër dhe tokë nga aktivitetet me mbeturina
- shfrytëzimin e mbeturinave për përfitim të energjisë,
- shfrytëzimi i mbeturinave për riciklim,
- ndërtimi i objekteve dhe instalimet për trajtimin e mbeturinave.
- përmirësimi aktual i shërbimeve për mbledhjen dhe zgjerimi i zonave të grumbullimit.
- përmirësimi i deponive funksionale për mbeturina,
- monitorimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave
- përmirësimi i monitorimit të aktiviteteve për menaxhimin e mbeturinave;
- rritja e inkasimit të mjeteve financiare të mbledhjes së pagesave nga familjet, institucionet për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave

2. GJENDJA E TANISHME

2.1 Vlerësimi i gjendjes, problemet dhe vështirësit

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë ballafaqohet me probleme evidente. Vonesat në zgjidhjen e vështirësive për menaxhimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave kanë rezultuar me situatën aktuale e cila nga aspekti menagjimit është e mangët ndërsa nga aspekti financiar është e rëndë. Sfidë jashtzakonisht e madhe është krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal, me të cilin sistem do të organizohet mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave nga territori i tyre. Njëri nga problemet deri më tani ishte edhe legjislacioni dhe ndarja e kompetencave për menaxhimin e mbeturinave.

Në përgjithësi gjendja aktuale e sistemit për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është shqetësuese, andaj kjo është arsyeja pse duhet ti jepet prioritet zgjidhjeve të përshtatshme për të gjitha problemet lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Krijimi i mbeturinave është në rritje, infrastruktura ekzistuese për sasinë e mbeturinave të krijuara është e pamjaftueshme dhe nuk përmbush standardet e BE-së. Kryesisht janë prezente këto vështirësi:

- Vetëdije e ultë e gjeneruesve të mbeturinave për menaxhimin e drejt të mbeturinave,
- Arsimim dhe edukim i pamjaftuar i komunitetit që gjeneron mbeturina dhe të punësuarve në kompanitë për menaxhimin e mbeturinave;
- Njohuri të pakëta për praktikën e menaxhimit të mbeturinave dhe trendet që aktualisht zbatohen në BE;
- Nuk bëhet mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave nga të gjitha zonat dhe vendbanimet e Republikës së Kosovës,
- Mungesa e makinerive dhe pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave;
- Mosdefinimi i përgjegjësive dhe kompetencave për menaxhimin e mbeturinave;
- Shkalla e ulët e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet e mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave;
- Mungesa e mjeteve financiare për realizimin e projekteve për menaxhimin e mbeturinave (trajtim, riciklim, pagesë të shërbimeve në deponitë)
- Krijimi i deponive ilegale të mbeturinave komunale;
- Mungesa e organizimit për ngritjen e sistemit për ndarje dhe klasifikim të mbeturinave komunale;
- Mos zbatimi i legjislacionit për mjedis dhe mbeturina;
- Mungesa e të dhënave për sistemin informativ lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
- Mungesa e dokumentacionit projektues dhe atij për identifikimin dhe përcaktimin e pronësisë së objekteve dhe infrastrukturës ekzistuese;
- Moszbatimi i parimit "ndotësi paguan";
- Vështirësi për funksionimin e sistemit regional për menaxhimin e mbeturinave.

Vetëdijësimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me nevojën për të shmangur krijimin e mbeturinave, konsiderohet si një përparësi në çdo sistem të menaxhimit modern të mbeturinave. Iniciativa për riciklimin e mbeturinave mungojnë, dhe në këtë drejtim

urgjentisht duhet të kërkohet një sistem i përshtatshme për ndarjen dhe mbledhjen e veçantë sipas llojeve të mbeturinave.

Deponitë e vjetra të mbeturinave komunale me mbështetje të MMPH-së, AER-it, Danida, GIZ dhe donatorve tjer janë rehabilituar dhe mbyllur përfundimisht.

Problem të madh paraqesin edhe deponitë industriale, sidomos deponit e krijuara në kuadër të aktiviteteve punuese minerare, metalurgjike dhe kimike që shtrihen në sipërfaqe të konsiderueshme. Masa e këtyre mbeturinave llogaritet që vetëm në Trepçe të jetë rreth 60 milion ton. Këto mbeturina përmbajnë sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda dhe vazhdimisht janë burim ndotës që paraqesin rrezik për ajrin, ujin dhe tokën.

Deponitë e hirit të KEK-Obiliq dhe deponia e Ferronikelit- Gllogoc, paraqesin problemet mjedisore, të cilat vlersohen si "Hot Spote", domethene janë sinjal i kuq për shëndetin e njeriut, florës dhe faunës. Në magazinat ku janë vendosura kimikatet e mbetura nga proceset në ish fabrikat që tani nuk punojnë, pjesërisht ato janë të riambalazhuar dhe përkohësisht ruhen në vende të caktuara në Kosovë. Këto paraqesin rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Një ndër problemet janë edhe mbeturinat medicinale për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës ka investuar në ngritjen e impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore në (7) shtat Qendra Regjionale Spitalore.

Mbetrinat e veqanta siq janë; bateritë, gomat e përdorura, mbeturinat shtazore, paisjet elektrike dhe elektronike, automjetet mbeturina dhe vajrat e përdorura, që të gjitha këto nuk kanë gjetur trajtim adekuat.

Mbeturinat komunale sipas kompetencave menaxhohen nga komunat, ashtu si është përcaktuar në Ligjin për mbeturina (Ligji 04/1-60). Ato mund t organizohen edhe në forma të regjioneve, varësisht se si do të konceptohet dhënia e shërbimeve nga komuna përkatëse.

Regjioni/Komuna	Numri i banorëve sipas Entit te Statistikave	Numri i fshatrave sipas ligjit për kufijt administrativ
Regjioni i Prishtinës	469472	
1. Gllogoc	58579	34
2. Fushë Kosova	34718	13
3. Lipjani	57474	58
4. Obiliqi	21548	17
5. Podujeva	87933	77
6. Prishtina	198214	40
7. Graçanica	11006	15
Regjioni i Pejës	311822	
8. Deçani	38984	28
9. Gjakova	94158	68

10. Istogu	39294	45
11. Klina	37585	42
12. Peja	95723	69
13. Juniku	6078	1
Regjioni i Mitrovicës	209649	
14. Mitrovica (jugore)	71601	37
15. Leposaviq	- (16,850)	46
16. Skënderaj	51317	51
17. Vushtrria	69881	63
18. Zubin Potoku	- (14,800)	27
19. Zveçani	- (16,850)	17
20. Mitrovica (veriore)	-	2
Regjioni i Prizrenit	386628	
21. Dragashi	33584	38
22. Rahoveci	55053	33
23. Prizreni	178112	71
24. Suhareka	59702	41
25. Malisheva	54664	38
26. Mamusha	5513	0
Regjioni i Gjilanit	187417	
27. Gjilani	90015	41
28. Vitia	46959	38
29. Kamenica	35600	56
30. Novobërda	6720	23
31. Ranillugu	3785	12
32. Parteshi	1787	2
33. Kllokoti	2551	3
Regjioni i Ferizajt	185734	
34. Ferizaj	108690	44
35. Kaçaniku	33454	29
36. Shtimja	27288	20

37. Shtërpca	6913	14
38. Hani i Elezit	9389	10
NUMRI I PËRGJITHSHËM	1.733.870	1263
	1.739.825	

Inkasimi i taksës për shërbimet e dhëna për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave është në nivel të ulët, nuk i përmbushin nevojat për të ngritur një sistem financiarisht të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale. Taksat e shërbimit për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave komunale inkasohen në shkallë prej 30% deri 65%. Ose për krahasim, shifra më e freskët e vitit 2011, sipas projektit të JICA-s në Regjionin e Prizrenit, mesatarja mujore e inkasimit është 46.7%. Ndërsa në zonën e qytetit të Prizrenit (koncentrimi i popullatës 45%) ku shërbimi kryhet gadi 100% ndërsa pagesa bëhet vetëm 45%.

Gjithashtu, mungesa e fondit mjedisor dhe instrumenteve tjera financiare dhe mos zbatimi i mjaftueshëm i legjislacionit për mbeturina, kanë sjell në gjendje që sistemi të jetë i paqëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave.

2.2 Pjesëmarrësit në menaxhimin e mbeturinave

Për menaxhimin e mbeturinave janë të përfshira këto struktura:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, komunat, kompanitë regionale publike, operatorët privat, bizneset si dhe pjesëmarrës tjerë. Struktura e sistemit për menaxhimin e mbeturinave dhe detyrimet ligjore janë paraqitur, si me poshtë:

2.2.1 Struktura administrative

Kuvendi i Republikës së Kosovës :

- Nxjerrja e ligjit për mjedisin, mbeturinat dhe dispozitat tjera relevantë;
- Nxjerrja e strategjisë për mbrojtjen e mjedisit;
- Djënia e rekomandimeve dhe monitorimi i zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit etj.

Qeveria e Republikës së Kosovës:

- Miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Nxjerrja e udhëzimeve administrative qeveritare;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH):

- Hartimi i legjislacionit;

- Hartimi i Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturinave në Republikën e Kosovës;
- Përgatitja e programeve për monitorim;
- Përgatitja e raporteve për gjendjen e mbeturinave;
- Dhënia e pëlqimit mjedisorë - veprimtarive në bazë të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Dhënia e licencës për menaxhimin e mbeturinave;
- Dhënia e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave;
- Mbikëqyrjen inspektive në zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore;
- Menaxhimin me mbeturina të rrezikshme;

Pushteti Lokal - Komunitat:

- Nxjerrja e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave
- Përcaktimi i lokacionit sipas për nevojat e menaxhimit të mbeturinave komunale etj, sipas planit hapësinor;
- Caktimi i tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Mbledhja dhe raportimi i shënimeve.
- Mbikëqyrja e zbatimit të Kartës së Konsumatorëve;
- Caktimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për mbledhjen e mbeturinave;

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës - KMDK

- Menaxhimin e deponive sanitare të mbeturinave komunale.

Kompanitë regjionale

- Kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vend banimet deri të deponitë sanitare.

Spektori Privat- Kompanitë e licencuara

- Merret me dhënien e shërbimeve për mbeturina të përcaktuara nga komuna;
- Bëjnë grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

2.3 Cikli i mbeturinave

Qarkullimi i mbeturinave nga vendi ku është krijuar deri në procesin përfundimtar, d.m.th. procedurat që përfshijnë mbledhjen, transportin, ripërdorimin, trajtimin, djegien dhe asgjësimin përfundimtar njihet si " cikël i mbeturinave."

Cikli i mbeturinave varet nga pronësia e mbeturinave, vendi në të cilin janë prodhuar, detyrimet dhe përgjegjësitë e subjekteve përgjegjëse në menaxhimin e mbeturinave.

Mbeturinat klasifikohen sipas Katalogut shtetrorë për mbeturina (Katalogu Evropian në kuadër të ligjit për mbeturina).

Në bazë të veçorive që kanë mbeturinat, mund të klasifikohen në:

- mbeturina të parrezikshme,
- të rrezikshme
- dhe inerte.


Mbeturinat, në bazë të vend burimit ndahen në:

- mbeturina komunale
- mbeturinat industriale;
- mbeturinat e veçanta;
- mbeturinat medicinale.

AMMK, ka publikuar Raportin e Gjendjes së Mbeturinave 2008/2009 nga i cili janë paraqitur të dhënat në vijim:

Tabela 4: Sasia ditore dhe vjetore e mbeturinave për banor

Llojet e mbeturinave	Mesatarja ditore në kg / banorë	Sasia vjetore kg/ banorë	Sasia vjetore në tonelata
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232541
Mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2014.5
Mbeturinat e hirit dhe zgjyrës	0.907	331	761426.5
Mbeturinat e ndërtimit/ shkatërrimit objekteve ndërtimore	0.200	73	167900
Mbeturinat tjera (ambalazh) plastikë, gomë, pesticide, elektronikë, dru etj.	0.360	131.4	302220
Mbeturinat nga Minierat	?	?	?
Total	2,0	729	1675977



Mbeturinat sipas llojeve

Gjithashtu, është në interes për hartimin e strategjisë që të dhënat e përfituara të pasqyrohen nga analiza e përbërjes fizike të mbeturinave komunale në Komunën e Prizrenit. Kjo analizë është punuar nga ekspert të JICA, në kuadër të projektit „ Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë „ Sasia totale e mbeturinave të përdorura për Studim të përbërjes së mbeturinave dhe ato të synuara për analiza tregohen në tabelën më poshtë, tab: 4-a

Tab, 4-a: Analiza e mbeturinave të synuara.

No.	Llojet e burimeve gjeneruese	Verë			Dimër (përfshirë hirin)			-Dimër (pa e përfshirë hirin)		
		Pika e zgjedhur	Pika e perzier	Total Analizu	Pika e zgjedhur	Pika e perzier	Total Analizu	Pika e zgjedhur	Pika e perzier	Total Analizu
1.	Amv. Në zone urbane	54.2	103.0	157.3	128.3	98.3	226.6	96.1	98.3	194.4
2.	Amv. Në zone rurale	96.3	20.9	117.2	79.1	0.0	79.1	59.4	0.0	59.4
3.	Restaurante	276.6	40.4	317.0	245.1	0.0	245.1	245.1	0.0	245.1
4.	Lokale tjera	362.4	0.0	362.4	57.4	0.0	57.4	31.3	0.0	31.3
5.	Pemëtari	-	-	-	50.8	0.0	50.8	50.8	0.0	50.8
6.	Qendra tregtare	-	-	-	298.5	111.8	410.4	298.5	111.8	410.4
7.	Zyra	21.6	0.0	21.6	12.8	0.0	12.8	8.2	0.0	8.2
8.	Shkolla	93.3	2.8	96.1	1,679.3	0.0	1,679.3	31.3	0.0	31.3
9.	Hotele	7.5	0.0	7.5	9.2	0.0	9.2	9.2	0.0	9.2
10.	Tezga tregu	587.5	0.0	587.5	212.2	0.0	212.2	209.4	0.0	209.4
11.	Rrugë & Sheshe	14.7	67.9	82.6	-	-	-	-	-	-

	Totali I përgjithshëm	1514.2	234.9	1749.1	2,772.7	210.2	2,982.8	1,039.3	210.2	1,249.4
	Pjesa e mbledhur në përgjithësi			66.2%			52.1%			31.6%

Për nevojat e kësajë strategjie, këto shënime konsiderohen aktuale dhe mund të përdorën për krahasime gjatë kalkulimeve për mbeturinat komunale në tërë teritorin e Kosovës.

2.3.1 Mbeturinat komunale

Në Republikën e Kosovës ende nuk ka të dhëna të plota për krijimin, mbledhjen, trajtimin e mbeturinave. Shërbimi për grumbullimin e mbeturinave komunale është ofruar afersisht 42% (viti 2007) përkatësisht 39 % (viti 2008) e popullatës. Në regjionin e Prishtinës është përqindje më e lartë e popullatës që merr shërbimin e mbledhjes me 64 % (për vitin 2007) përkatësisht 52 % (për vitin 2008), ndërkohe që në regjionin e Mitrovicës përqindja e mbledhjes së mbeturinave komunale është më ulëti me vetëm 29 % (2007-2008). Në zonat urbane shërbimi i mbledhjes së mbeturinave bëhet gadi 100 %, ndërkaq zonat rurale aktualisht mbulohe me këtë shërbim në rreth 35 %, por me tendencë rritjeje.

Bazuar në informacionet e projektit nga JICA, në komunën e Prizrenit aktualisht ofrohen shërbimi i mbledhjes së mbeturinave 87.2% në zonën urbane ndërsa në zonën rurale 73.5%. Shërbimet e ofruara, kryesisht bëhen me kontratë. Bazuar në regjistrimin e vitit 2011, qyteti i Prizrenit me popullatë 93,511 banorë dhe nr. të amvisrive 16,970, nga të cilët 12,733 kanë kontrata me kompaninë Ekoregjioni, dmth. shkalla kontraktuese është 75,0%. Ndërsa shkalla kontraktuese në zona rurale është 88,0%(18 fshatra). Kjo don të thot se ekzistojnë amvisri të cilat ende refuzojnë të bëjnë kontratë edhe pse shërbimi për disa të tilla bëhet. Nga këtu mund të konstatohet se në një pjesë të zonës, mbeturinat hudhen në mënyrë ilegale si në zonën urbane ashtu edhe në zonën rurale duke perfshirë edhe fshatrat ku nuk ofrohet shërbimi.

Duke krahasuar të dhënat për mbeturinat e deponuara në deponitë sanitare për vitin 2007, 2008 dhe 2009 vërehet se në të gjitha deponitë regjionale dhe komunale të mbeturinave komunale ka pasur rritje të sasis së deponimit të mbeturinave.





Figura 1. Sasia e mbeturinave në 3 vite me radhë (sipas AKMM)

Nga grafiku mund të konkludohet se edhe sasia e krijimit të mbeturinave gjatë vitit 2009, ishte më e madhe. Kjo rritje e sasisë së mbeturinave ka rezultuar për shkak të rritjes së sasisë së mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara, por edhe për shkak të zgjerimit të shërbimit.

Shërbimet për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave komunale kryhen me frekuencë të zakonshme dhe të njëjtë, pothuajse në të gjitha komunat. Brenda qytetit shërbimet për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave komunale kryhen të paktën një herë gjatë ditës, ndërsa në lagjet periferike të qytetit dhe zonat rurale sipas nevojës dhe marrëveshjes.

Nga një hulumtim i realizuar nga ZRRUM rezulton se 61.2% e respondentëve kanë deklaruar se janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, ndërsa 14.3% rezultojnë të jenë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me këto shërbime Fig 2.

Fig. 2. Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave



Rreth 90-95% e popullsisë urbane në Kosovë, janë të përfshirë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Të gjitha shërbimet janë të standardit të ulët për shkak të mungesës së objekteve dhe pajisjeve adekuate nga kompanitë publike. Zonat rurale mbulohen me shërbim përafërsisht 20-35 %.



Taksat për grumbullimin e mbeturinave janë mesatarisht 4€/për familje/muaj dhe pagesa e faturave mujore është 40-50%.

Bazuar në informacionet e marra nga ndërmarrjet publike, në lidhje me pajisjet dhe makineritë që përdoren për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave komunale, është llogaritur se rreth 80% e automjeteve janë më të vjetra se 10 vjet.

Tabela: 4-c. Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të deponuara në deponitë të kontrolluara dhe në ato ilegale gjatë vitit 2008, 2009 dhe 2010.

Tab,4-c.

viti	Sasia e përgjithshme e mbet. komunale në Kosovë, [ton]	Mbeturinat e deponuara në deponitë të kontrolluara	Mbeturinat e hedhura në deponi ilegale
2008	384710	218402 t (56.77 %)	166.308 (43.23 %)
2009	384710	247206 t (64.26 %)	137504 (35.74 %)
2010	384710	255546 t (66.43 %)	129164 (33.57 %)

Nga tabela e lartëshënuar vërehet se sasia në % e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale në nivel vendi shkon duke u përmisuar gjegjësisht duke u rritur sasia e mbeturinave të gjeneruara për deponim

2.3.2. Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit (C&D)

Në Republikën e Kosovës është duke ndodhur ndërtim i hovshëm i objekteve ndërtimore, kështu që tani jemi duke u përballur me rritjen e sasisë së mbeturinave me prejardhje nga ndërtimi dhe rrënim i objekteve të banimit dhe objekteve tjera. Hedhja dhe grumbullimi i tyre në vende që nuk kanë qenë të destinuara për këtë qëllim ka keqësuar edhe më shumë gjendjen në këtë sektor. Sidomos është shqetësuese dukuria e zënies së sipërfaqeve të tokave të punueshme dhe pranë brigjeve të lumenjve nga hedhja e këtyre mbeturinave.

Për mbeturinat e konstruktimit dhe demolimit duhet të përcaktohen vende për trajtimin dhe deponimin e tyre. Pasi që mbeturinat inerte të klasifikohen nga mbeturinat tjera, ato mund të hudhen për mbushjen dhe rehabilitimin e gropa ose hendeqeve inxhinerike. Po qe se keto mbeturina hudhen si të përziera me materiale tjera mbeturinë atëher përveç dëmtimit të peizazhit mbeturinat e ndërtimit kanë ndikim të dëmshëm në mjedis, në ekosisteme, sidomos në rastet kur ato hedhen të përziera me mbeturinat të tjera komunale.

Qeveria e Kosovës është duke marrë në konsideratë një opsion për të përdorur mbeturinat C&D për bonifikimin e tokës. Duhet kooperuar me MBPZHR për nevojat e një studimi të fizibilitetit për



bonifikimin e tokës në secilën komunë.

Qeveria do të angazhohet që përmes komunave:

- Të marrë masa për të shmangur krijimin e mbeturinave, që nga faza e planifikimit të ndërtimit;
- Shqyrtuar mënyrat se si më mirë mund të zgjatet jeta e ndërtesave të dobishme dhe pjesëve saj;
- Të sigurojë ndihmë për përdorimin e materialeve të riciklueshme në ndërtimin e ndërtesave të reja, dhe
- Japin këshilla mbi toksiciteti i materialeve dhe ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut pas ndërtimit apo demolimit të objektit ndërtimorën.

Sasia e mbeturinave C&D që krijohet në osovë është përafërsisht 167,900ton/vit.

Qeveria e Kosovës po shqyron mundësinë e dekomisionimit të TemoCentralit Kosova-A, e cila sipas Strategjisë së Energjisë e Kosovës 2009-2018, do të fillojë diku kah viti 2017, Në këtë kohë nga demolimi i objekteve në zonën e TC Kosova -A do të krijohen sasi të mëdha të mbeturinave , të cilat do të trajtohen dhe deponohen me projekt të veçant.

2.3.3. Mbeturinat industriale

Mbeturinat industriale përfshijnë të gjitha mbeturinat që krijohen nga zhvillimi i aktiviteteve që kanë si rezultat prodhimin e ndonjë produkti industrial. Republika e Kosovës në të kaluarën kryesisht ka pas të zhvilluar eksploatimin e xehes dhe metalurgjinë kështu që me kalimin e kohës shumica e kapaciteteve industriale dhe teknologjike janë vjetruar dhe kanë ndërprerë aktivitetet, duke u shndërruar në mbeturina. Mbeturinat industriale përfshijnë të gjitha mbeturinat që krijohen nga zhvillimi i aktiviteteve që kanë si rezultat prodhimin e ndonjë produkti industrial. Republika e Kosovës në të kaluarën kryesisht ka pas të zhvilluar eksploatimin e xehes dhe metalurgjinë kështu që me kalimin e kohës shumica e kapaciteteve industriale dhe teknologjike janë vjetruar dhe kanë ndërprerë aktivitetet, duke u shndërruar në mbeturina.

Gjithashtun edhe tani krijohen mbeturina nga procesi i prodhimit të produkteve të ndryshme. Nuk ekzistojnë shënime të sakta për sasinë dhe llojin e mbeturinave industriale. Mbeturinat industriale janë kryesisht mbeturina të rrezikshme që krijohen nga industria dhe nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Sasia e mbeturinave industriale, ka rënë ndjeshëm që nga viti 1999. Disa deponi të mbeturinave industriale deri në një masë, janë rehabilituar. Të gjitha mbeturinat industriale të krijuara në Kosovë paraqesin një rrezik serioz për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nëse nuk menaxhohet dhe trajtohen në mënyrë të sigurtë.

Aktualisht është një inventar, por jo i plotë në dispozicion, me sasinë e mbeturinave industriale dhe industriale të rrezikshme që janë prodhuar deri më 1999.

Mbeturinat në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës-KEK

Në procesin e prodhimit të energjisë elektrike në termocentralet- KEK në Obiliq krijohen mbeturina të hirit dhe të tjera. Llojet e mbeturinave që krijohen prej kohësh që

edhe më tutje krijohen në vazhdimsi janë: sterilet, hiri, lymi i hirit, vajra të përdorura, skorie (zgjyra), pluhuri i furrave, materie kimike (fenoli, katrani etj.), mbeturina të ngjyrave, goma (shirita, goma të makinave dhe të tjera), metale (pjesë metalike), vajra me PCB dhe pajisje që përmbajnë PCB -si trafoelektrike.

Deponia e hirit e TC- A së bashku me djerrinat dhe lagunën, përbëjnë një sipërfaqe prej rreth 234 ha. TC-et A dhe TC- B, së bashkë, prodhojnë më shumë se 1 milion ton të hirit në vit. Nga kjo sasi afërsisht 700.000 ton, janë të depozituara në deponitë e hirit, ndërsa afërsisht 300.000 ton, lirohen në ajër.

Sipas strategjisë për energjinë, gjatë viteve në vijim dhe deri në vitin 2017 përveq ndërtimit të termocentrilit Kosova e re, planifikohet të ndodhin aktivitete për dekomisionimin e TC -ve Kosova A, nga të cilat aktivitete pritet të krijohen sasi të mëdha të mbeturinve.

Mbeturinat e Kombinatit industrial - TREPÇA

Në kuadër të aktiviteteve minerare, metalurgjike dhe kimike të Kombinatit industril-“Trepça”, përkatësisht procesit të eksploatimit, pasurimit dhe finalizimit të lëndës së parë krijohen mbeturina. Vlen të theksohet se përmbajtja e metaleve të rënda në këto mbeturina është relativisht e lartë për shkak të shkallë së ulët të shfrytëzimit të metaleve gjatë këtyre proceseve.

Në tabelën 5, janë paraqitur deponitë e krijuara, materiali i deponuar (mbeturina), statusi i deponisë, sipërfaqja në të cilën shtrihet deponia dhe sasia e mbeturinës.

Tabela 5. Deponitë industriale të Trepçës

Vendi	Materiali i deponuar (mbeturina)	Statusi i deponisë	Sipërfaqja e deponisë, [ha]	Sasia, (t)
Mitrovicë - PIM	Fosfogjips	Jo aktive	10	4x10 ⁵
Mitrovicë- PIM	Pirit, pirotinë	Jo aktive	9	5x10 ⁵
Mitrovicë- PIM	Fundërresë prej procesit të finjzimit neutral	Jo aktive	10	5X10 ⁵
Mitrovicë- PIM	Jarosit	Jo aktive	5,4	1,2x10 ⁵
Leposaviq	Fundërresë	Jo aktive	6,5	2,6 x10 ⁶
Leposaviq	Fundërresë	Aktive	8-10	3,6x10 ⁶
Zveçan	Fundërresë	Jo aktive	26	8,5x10 ⁶
Zveçan	Fundërresë	Jo aktive	50	12x 10 ⁶
Kelmend	Fundërresë	Aktive	8-10	3,6x10 ⁶
Graçanicë	Fundërresë	Jo aktive	40	11x10 ⁶
Badovc	Fundërresë	Aktive	18	7,7x10 ⁶
Artanë	Fundërresë	Jo aktive	4	1,8x10 ⁶
Zveçan	Zgjyrë Pb	Jo aktive	4-6	2,5x10 ⁶
Zveçan	Hi	Jo aktive	10-15	10x10 ³

2.3.4. Mbeturinat e bujqësisë dhe industrisë ushqimore

Mbeturinat nga bujqësia dhe industria e ushqimit, përfshijnë nus-prodhimet nga thertoret, eshtrat e kafshëve dhe kafshët e ngordhura, plehurat e kafshëve. Në industrinë e prodhimeve dhe përpunimit të qumështit, mishit, miellit, pijeve të ndryshme alkoolike dhe joalkoolike etj. gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre për përfitim të produkteve krijojnë mbeturina, por mbeturinat krijojnë edhe gjatë dhe pas konsumimit të produktit ushqimor ose pas skadimit të afatit të përdorimit.

Gjatë importit të produkteve ushqimore të cilat pas skadimit të afatit ose për shkak të ambalazhimit të dobët gjithashtu një sasi e konsideruar e tyre bëhet mbeturinë.

Nuk ekzistojnë të dhëna për sasinë e krijuar të mbeturinave nga dega e bujqësisë dhe industrisë ushqimore.

2.3.5. Mbeturinat e rrezikshme

Kosova nuk posedon infrastrukturë të përshtatshme për trajtimin/asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme. Deri më tani në Republikën e Kosovës ende nuk është ngritur ndonjë objekt për ruajtjen apo deponimin e mbeturinave të rrezikshme.

Disa substanca dhe përzierje në gjendje të ndryshme agregate kanë mbetur për shumë kohë pa u përdorur, ato gjenden nëpër stabilimente, të vendosura në magazina dhe reparte të ndryshme industriale. Disa nga këto substanca apo përzierje kimike në formë të mbeturinave, iu ka skaduar afati apo janë degraduar duke ndryshuar përbërjen e tyre, këto konsiderohen si mbeturina me rrezikshmëri të lartë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Deri më tani, në disa ndërmarrje që posedojnë këtë lloj të mbeturinave, janë zhvilluar aktivitete për rimbaltimin e mbeturinave të rrezikshme me qëllim për të zvogëluar rrezikun nga substanca të këtilla. Redukimi i rrezikut është bërë kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe FSK-së.

Nuk ekzistojnë të dhëna të plota për sasinë e mbeturinave të rrezikshme.

Do të duhet një projekt i titulluar "Inventar mbeturinave të rrezikshme në Kosovë".

Projekti do të rezultoi në:

- Një vlerësim të situatës aktuale në lidhje me mbeturinat e rrezikshme në Kosovë;
- Informimi i prodhuesve, operatorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në detyrimet përkatëse në fushën e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme;
- Regjistrimi i mbeturinave të rrezikshme;
- Inventarin kombëtar të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë;
- Propozimet për ndërmarrjen e politikave legjislative dhe masa administrative;



Të gjithë personat që dëshirojnë të transferojnë mbetjeve të rrezikshme në shtetet tjera duhet së pari të aplikojë për një leje eksporti, si një formë për zgjidhje të përshtatshme. Pas lëshimit të lejes, të gjitha lëvizjet e mëvonshme të mbeturinave të autorizuara në bazë të kësaj leje duhet të njoftohet Autoritetit në shtetet përkatëse. Qeveria mbetet e angazhuar që brenda afatit të strategjisë të krijoj kushte për ruajtjen e përkohshme para-trajtimin ose para se me u eksportuar në objektet për magazinim

2.3.6. Ambalazhet dhe ambalazhet mbeturinë

Republika e Kosovës është importues i shumë mallrave dhe produkteve të cilat kryesisht janë të ambalazhura në një e më shumë ambalazhe dhe që krijojnë sasi të mëdha të mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet e ndryshme. Masat e marra deri më tani janë të pakta dhe legjislacioni në fuqi nuk është implementuar në tërësi në zgjidhjen e këtij problemi. Ripërdorimi dhe riciklimi i tyre ndodh nga disa kompani private të cilat ende nuk është i organizuar mirë në sistem të ciklit të mbeturinave. Mungojnë të dhëna për sasinë e krijuar të këtyre mbeturinave.

2.3.7. Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre

Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet kryesisht nga nga disa kompani private Ato, mbeturinat i trajtojnë në dy mënyra: njëra është duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje, të cilat kryesisht shitën në vende të rajonit si dhe tjetra duke i i çmontuar pjesët e tyre për ti ripërdorur. Sasia dhe numri i saktë i tyre nuk dihet.

2.3.8. Mbeturinat e gomës

Gomat e përdorura të automjeteve në vendin tonë importohen ose grumbullohen me qëllim të ripërdorimit ose ripërpunimit përmes ri-veshjes së tyre. Gomat e automjeteve nuk kategorizohen si mbeturinë e rrezikshme, por disa lloje specifike mund të kenë përbërës të tretshëm dhe të rrezikshëm.

Nga djegia e pakontrolluar e gomave mund të lirohen substanca të rrezikshme për mjedisin si p.sh dioksina.

Kryesisht ato digjen në furra primitive për pjekjen e gëlqeres.

Sasia e mbeturinave të gomës dhe numri i saktë i importimit të gomave nuk dihet.

Sasia e përgjithshme e mbeturinave nga gomat e makinave do të vlersohet përafërsisht Makinat e regjistruara në Republikën e Kosovës në vitin 2008 ishte 206,352 makina.

Numri i mesatare i gomave për makinë -5 copë.

Numri i gomave aktualisht në përdorim 1,031,760 copë.

Duke supozuar se jeta mesatare e një gomë është 5 vjet dmth. 10.000 km/vit duke pasur parasysh se gomat e makinave që dalin nga përdorimi pas 50.000 kilometra të kaluara.

Numri i gomave të importuara për vit sillet përafërsisht: $1,031,760/5 = 206,352$ gom/vit.

Mesatarja e peshës për gomat e reja = 23 kg/gom; (makina- 8 kg/gom, kamionet e lehtë përfshirë edhe ata me 4x4 rrota-11kg/gom, mauneve 52 kg/gom).

Mesatarja e peshës për gomat e shpenzuara = 18.5 kg

Gomat e makinave që hedhen për vit: $18.5 \times 206,352 = 3,817.5$ ton

Gomat e nxjera jasht përdorimit nga makinat e vjetra: 5,000 makina / vit x 5 copa/vit = 25,000 goma

Sasia e përgjithshme e gomave të hedhura nga makinat e jasht përdorimit përafësisht 462.5 ton

Në total për vit gjenerohen 4280 ton goma që perfundojnë si mbeturinë

Tab: 5-a, Përbërja e gomave:

(% peshore)	Gomë	Celik	Textil
Goma të makinave	86%	10%	4%
Goma te mauneve	85%	15%	<0.5%
Sasia e mbeturinave [ton]	~ 3638	~ 535	~ 107
Totali [ton]	4280		

Vlerat janë kalkuluar nga stafi i DMK.

Aktualisht nuk ekziston një kompani në Kosovë e cila ka investuar në makineri për grirjen e gomave dhe për të ndarë gomën, çelikun dhe tekstilet.

2.3.9. Mbeturinat elektrike dhe elektronike

Pajisjet elektrike dhe elektronike pas përdorimit të tyre shndërrohen në mbeturina, të cilat në mungesë të ripërdorimit dhe riciklimit paraqesin mjaft problem për mjedisin, për shkak se këto përmbajnë disa komponente të rrezikshme. Nuk ka të dhëna për sasinë e krijuar, por dihet se sasia e tyre është në rritje të vazhdueshme duke pasqyruar importin e pajisjeve të reja dhe të përdorura.

2.3.10. Mbeturinat nga përpunimi i ujërave të ndotura

Në Republikën e Kosovës ende nuk është ndërtuar ndonjë impiant me kapacitete të mëdha që bënë trajtimin e ujërave të zeza ose ujërave të ndotura. Në përgjithësi nga këto ujra bëhet ndotje e madhe e lumenjeve dhe ujërave tjera sipërfaqësore dhe nëntoksore.

Nga masa e ujërave të zeza konsiderohet që në përbërjen e tyre 25% është materie e ngurtë, e cila do të duhet ndarë dhe trajtuar. Gjatë vitit 2012 është funksionalizuar impianti për trajtimin e ujërave të zeza në qytetin Skenderaj.

Bazuar në të dhënat më të mira të mundshme nga tab 5-b, totali i shkarkimit të ujërave të zeza në 2004-tën në Kosovë është rreth 1,200 l/s, apo 110,000 m³/d. NBO dhe ngarkesat e trupave të ngurtë janë 8,500 kg/d, respektivisht 29,000 kg/d.

Tab. 5-b, Shkarkimet e ujërave të zeza në Kosovë

Komuna		Rrjedhja (l/s)	NBO (mg/l)	Trupat e ngurtë (mg/l)
Viti	Komuna	4	130	190
Vushtrri	Komuna	25	130	190
Glogovc	Komuna	2	130	190
Gjilan	Komuna	29	130	190
Deçan	Komuna	37	130	190

Dragash	Komuna	19	130	190
Gjakovë	Komuna/metalurgjia	30 - 17	130 - 15	240 -250
Istog	Komuna	8	130	190
Kaçanik	Komuna /materiali ndërtues	5 - 18	130 - 10	190 -150
Klinë	Komuna	10	130	190
Kamenicë	Komuna/jo-metalet	4 - 16	130 - 15	190 - 1,000
Mitrovica	Komuna/metalurgjia	65 - 363	120 - 15	290 275
Leposaviq	Komuna/metalurgjia	1 - 44	130 - 15	240 - 410
Lipjan	Komuna/jo-metalet	4 - 48	130 - 20	190- 1,000
Rahovec	Komuna	11	130	190
Pejë	Komuna	116	170	190
Podujevë	Komuna	16	130	190
Prizren	Komuna /impianetet e energjisë	106 - 27	140 - 20	190 - 250
Prishtinë	Komuna/impianetet e energjisë, metalurgjia	186	140 - 20	190 - 275
Skenderaj	Komuna	3	130	190
Suharekë	Komuna	11	130	240
Total		110,000 m³/d	8,500 kg/d	29,000 kg/d

Studimi mbi strategjinë për trajtimin e ujërave të zeza

Kemwater Services Oy

Qershor 2004

2.3.11. Mbeturinat e vajrave

Mbeturina me vajrave dhe vajrat e përdorura paraqesin ndotje të madhe të dheut dhe ujrave, për shkak se ato derdhen në çdo vend ndizen në vatra të thjeshta për ngrohje dhe përdoren si lëndë djegse për prodhimin e avullit në impianetet e ndryshme industriale. Në vendin tonë vajrat e përdorura pjesërisht grumbullohen për të u ripërdorur ose djegur për përfitimin e energjisë së nxehtësisë dhe ende nuk ekziston ndonjë qendër për riciklim.

2.3.12. Bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar

Në treg ekzistojnë shumë lloje baterish të cilat përbehen prej materialeve të ndryshme dhe të mbushura me elektrolit. Disa përbërës të tyre kanë veti toksike dhe kancerogjene. Bateritë e konsumuara janë mbeturina që kërkojnë trajtim të veçantë. Nuk ka të dhëna të sakta për importin dhe prodhimin e baterive brenda një viti në Kosovë, ashtu siç nuk kemi shënime për sasinë numër të saktë për mbeturinat e tyre. Në vendin tonë ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme për riciklimin e baterive nga plumbi si psh. në repartin e “Trepçës” –Zveçan dhe disa qendra trajtimi të pa licencuara, kompani private nëpër Kosovë.



2.3.13. Mbeturinat nga produktet medicinale

Mbeturinat nga produktet medicinale janë mbeturina që mund të paraqesin rrezik gjatë manipulimit apo në kontakt me to, rrezikohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi. Edhe ky lloj i mbeturinave nuk trajtohet në mënyrë të duhur. Nga monitorimi në terren dhe nga të dhënat që i kemi, këto mbeturina nuk administrohen si duhet, nuk transportohen dhe pjesërisht trajtohen sipas normave dhe standardeve të parapara të BE-së. Për sterilizimin e mbeturinave medicinale infektive janë ngritur shtat (7) impiante për sterilizim të këtyre mbeturinave në qendrat kryesore spitalore të Kosovës. Ndërsa për djegie të mbeturinave medicinale siq janë barërat me afat të skaduar në vendin tonë ekzistojnë katër incinerator të cilët pjesërisht plotsojnë kushtet e duhura. Në Kosovë përafërsisht krijohen 2014, 5 ton në vit mbeturinë medicinale.

2.4 Procedurat e menaxhimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është një aktivitet mjaft kompleks që ushtron një ndikim të madh në të gjitha degët e ekonomisë, prodhimit dhe konsumit. Në përgjithësi menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës në bazë të konceptit hierarkik - zvogëlimi, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave janë të rëndësishme hapat në vijim:

- Zvogëlimi i krijimit të mbeturinave dhe zvogëlimi i rrezikut nga mbeturinat:
 - Edukimi dhe arsimimi për vetëdijsimin e komunitetit;
 - Inkurajimi i prodhimit të pastër dhe prodhimi;
 - Subvencionimi financiar i sektorit për menaxhimin e mbeturinave;
 - Hartimi i planeve për menaxhimin e mbeturinave.
- Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave
 - Grumbullimi i ndare në lloje;
- Trajtimi i mbeturinave
 - riciklimi dhe përdorimi;
 - trajtimi mekanik;
 - trajtimi biologjik;
 - trajtimi termik;

- trajtimi fiziko-kimik
- Deponimi përfundimtarë i mbeturinave
Deponimi i mbeturinave në deponi sanitare

2.4.1 Deponimi

Në kuadër të menaxhimit të mbeturinave, deponimi është option i fundit, por domosdoshëm i trajtimit të mbeturinave në Kosovë, i cili duhet të bëhet duke zbatuar standardet më të larta teknike me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Tabela 6: Deponitë Sanitare në Republikën e Kosovës

Deponitë Sanitare:	Regjioni	Tipi i Deponisë	Sip ha.	Banorë	Periudh kohore
Prishtinë	Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan Obiliq, Gllogoc,	Regjionale	40	724.251	15
Gjilan	Gjilan, Kamenicë, Viti, Ferizaj, Novobërdë	Regjionale	24	242.195	15
Prizren	Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Gjakova	Regjionale	24	316.728	15
Podujevë	Podujevë	Komunale	5	131.300	15
Mitrovicë	Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj	Regjionale	7	250.000	15
Pejë	Pejë, Deçan, Klinë, Istog	Regjionale	3.6	250.000	
Sharr	Sharr	Komunale	1.2	27.000	16
Ferizaj	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpç, Hani i Elezit	Stacion transferi		210.120	
Zveçan	Zveçan	Komunale			15
Gjithsej				2.151.159	

Burimi: Raporti i gjendjes së mbeturinave 2008 AMMK, 2009

2.5 Objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave

Nuk ka shifra të sakta lidhur me numrin se, sa kompani apo objekte të trajtimit të mbeturinave ekzistojnë në Republikën e Kosovës. Në tregun e mbeturinave dominojnë grumbulluesit dhe eksportuesit e metaleve të ndryshme, ata të plastikës dhe përpunimit të sajë, të letres, të akumulatorëve, importuesit e gomave të përdorura dhe prodhuesi i vajrave. Gjithsejt janë evidentuar 36 kompani të cilat në mënyra të ndryshme merren me menaxhimin e mbeturinave dhe eksportimin e tyre jasht vendit.

2.6 Sanimi i deponive të mbeturinave

2.6.1 Deponitë e mbeturinave komunale

Gjatë vitëve 2007, 2008 dhe 2009 investimet janë orientuar në rehabilitimin e disa deponive dhe mbylljen e plotë të deponive të vjetra të mbeturinave komunale. Në kuadër të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë vitit 2007 ka investuar në rehabilitimin e tri deponive të mbeturinave komunale në: Kaçanik, Prizren dhe Gjakovë, ndërsa gjatë vitit 2008 janë rehabilituar deponitë në: Lipjan, Prizren dhe Gjilan. Pas vlersimit të gjendjes së deponive të vjetra të mbeturinave komunale, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë mbylljen

përfundimtare të tetë deponive të vjetra të mbeturinave komunale në: Prishtinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kaçanik, Gjakovë, Klinë, Podujevë dhe Ferizaj.

2.6.2 Deponimi i mbeturinave nga industria ekstraktive, minierave dhe mbeturinave të tjera industriale

Qëllimet e menaxhimit të mbeturinave komunale është që në Republikën e Kosovës operatorët të përfillin dispozitat ligjore të UA për administrimin e deponive që është e lidhur me Direktivën e Deponive të KE (99/31/EC), për mënyrën e menaxhimit të deponive për mbeturina komunale. Sigurisht që afatet që përcakton direktiva për deponi, në Kosovë nuk do të mund të zbatohen por çdo iniciativë për reduktimin e mbeturinave komunale biodegraduese do të konsiderohet si sukses i qeverisë dhe institucioneve lokale .

Edhe për deponitë industrial janë dhënë donacione nga AER dhe UNDP për rehabilitimin e tyre si që janë deponia e Artanës deponia e Kelmendit dhe deponia në Graçanicë. Avancimi i sistemit për deponimim e mbeturinave industrial duhet ti stimuloj aktivitetet për eksploatim komercial të mbeturinave të deponuara që mund të valorizohen për shkak të përmbajtjes së lartë të metaleve në to. Megjithate vendet e konsideruara si „hot spote” duhet të trajtohen dhe rregullohen me qëllim që të eliminohen ose reduktohen rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3. MASAT DHE OBJEKTIVAT

3.1 Masat për realizimin e objektivave të strategjisë

Objektivat dhe ndërmarrja e masave sipas kësajë strategjie janë në përputhje me parimin bazë të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave, në mënyre që reduktohet sasia dhe ndikimi negativ i mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut duke krijuar kushtet për zvogëlimin sasisë së mbeturinave në vend burim, zvogëlimi i rreziqeve që mund të paraqiten nga mbeturinat, ripërdorimin, djegien për shfryztim të energjis, dhe riciklimin si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave për deponim.

1. Zvoglimi i krijimit të mbeturinave në vend burim dhe zvogëlimi i sasive të mbeturinave që duhet të deponohen:

- a) Zvoglimi i krijimit të mbeturinave në vend burim, duhet të arrihet përmes edukimit të publikut, përdorimit të instrumentëve ekonomike, hartimit të planeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e legjislacionit dhe investimeve në teknologji më moderne etj.
- b) Organizimi i mbledhjes së mbeturinave të ndara në lloje (ndarja në lloje) që në vend burim.
- c) Ripërdorimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave (mbeturinat e ambalazhit, automjetet mbeturinë, mbeturinat nga paisjet elektrike dhe elektronike etj.).

2. Zhvillimi i infrastrukturës për ngritjen e sistemit të integruar për menaxhimin e mbeturinave:

- a) Harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së;
- b) Ngritja e sistemit për informim dhe integrim në sistemin informativ të BE-së;
- c) Ndërtimin e objekteve dhe paisjeve (objekte për trajtimin mekaniko-biologjik të mbeturinave, objektet për djegie dhe përfitim të energjisë, objekte për kompostim, deponi etj);
- d) Ngritjen e kapaciteteve shërbyese për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- e) Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave sidomos në komuna.

3. Zvogëlimi i rrezikut nga mbeturinat

- a) Përdorimi i praktikave me të mira për menaxhimin e mbeturinave,
- b) Përmirësimin e gjendjes së deponive ekzistuese ose mbyllja e tyre,
- c) Përdorimin e kapaciteteve ekzistuese industriale për asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme.

4. Rritja e punësimit

- a) Zhvillimin e industrisë vendore dhe biznesëve,
- b) Përmirësimin e nivelit aktual të organizimit në industrinë vendore,
- c) Ngritja e kapaciteteve teknike për mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave komunale.

5. Trajnimi i personelit

Menaxhimi me mbeturina është proces kompleks që kërkon veprim të harmonizuar të administratës shtetërore, njërive rajonale dhe lokale, studiuesve, ekspertëve, shoqatave, bizneseve, mediave dhe publikut. Kjo sfidë më lehtë do të kalohej nëse të gjitha palët informohen siç duhet dhe inkurajohen të marrin pjesë në proceset e vendim marrjes në sferen e menaxhimit me mbeturina, duke ndërmarr këto masa:

- të veprohet sipas parimit për mësim të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës,
- të krijohen kushte për edukim dhe trajnim në fushën e menaxhimit të mbeturinave,
- të ngritet vetëdija dhe përgjegjësia për menaxhimin e mbeturinave, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror,
- të kuptohet që problemet me mbeturina janë probleme tonat,
- të sigurohen informacione të sakta, të plota dhe në kohe,
- të promovohen parimet dhe prioritetët në menaxhimin e mbeturinave,
- të promovohen partneritet me të gjithë palët e interesuara për menaxhimin e mbeturinave.

3.2 Objektivat në afat kohorë për administrim të mbeturinave

Objektivat e përcaktuar me afat kohor për realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie janë paraqitur në tabelën 7.

Tablea 7. Objektivat për realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie

Qëllimet	Përqindja (%)/ vit			
	2013	2015	2019	2022
Grumbullimi i mbeturinave komunale	50	70	80	90
Ndarja në lloje e mbeturinave komunale	0	20	30	50
Trajtimi i mbeturinave	10	20	35	40
Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi	90	80	65	60
Sasia e mbeturinave biodegraduese të hedhura me mbeturina komunale	95	85	70	40

Deri në vitin 2022 parashihet që 90% e popullatës në Republikën e Kosovës të përfshihet në mbledhjen e organizuar të mbeturinave, dhe gjithashtu përqindja e mbeturinave komunale të destinuar për trajtim të mëtutjeshëm dhe riciklim të rritet deri në 40 %.

Tablea 8. Objektivat për riciklim dhe ripërdorim të mbeturinave të veçanta

Mbeturina	Afati fundit	Proporcioni (% masore)	
		Ripërdorim	Riciklim
Mbeturinat e ambalazhit	2018 2022	40-65	40-55
Automjetët mbeturinë	2018 2021	60-70	90-95
Mbeturinat elektrike dhe elektronike	2018 2021	70-80	80-90
Mbeturinat e gomës	2018 2022	30-70	20-30
Vajrat mbeturinë	2018 2022	40-60	-

Njëri nga synimet për menaxhimin e mbeturinave komunale është promovimi i riciklimit të mbeturinave të ngurta komunale sipas projektit JICA në komunën e Prizrenit, do të paraqitet se duhet të përkrahet ndarja e gjërave të riciklueshme, të fillohet me kompostimin e mbeturinave organike si formë e riciklimit. Në zonat urbane të ndahen për riciklim 5.0% e mbeturinave organike-deri më 2022 (aktualisht 0.0%). Në zonat rurale të ndahen për riciklim 20.0% e mbeturinave të kuzhinës - deri në vitin 2022 (aktualisht 1.0%) dhe mbeturinat e tregut të ndahen për riciklim 50.0% - deri në vitin 2022 (aktualisht 0.0%).

Gjithashtu është parashikuar se nga mbeturinat komunale do të grumbullohen me qëllim riciklimi mbeturinat sipas dinamikës në tab. 8-a

Tab 8-a. Ndarja e materialeve për riciklim

Loji i materialit për riciklim	Grumbullimi i synuar [%]	Grumbullimi aktual [%]	Viti i synuar
Metali	80	62.1	2021

Letëra	30	18.7	2021
Plastika	30	13.0	2021
Shishe/xham	20	7.8	2021

Për krahasim jepet nje pasqyrë e *Objektivave* nga legjislacioni i BE-së për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave Tab 8-b.

Tab 8-b Objektivat e legjislacionit Evropian

SYNIMET NË LIGJET E BE-së PËR MBETURINAT				
		Min. përpunim	Min. riciklim	mbledhje
Paketimet	2008	60%	55%	
Makinat	2015	95%	85%	100%
Elektronike	2006	70%	50%	Min. 4kg për banor për vit
Bateritë	2011		50% deri 75% (efficiency)	
	2012			25%
	2016			45%
Gomat	2006	0 – deponim I gomave nw deponi		
Biombeturinat nga deponitë	2006	Reduktim 75 % nga niveli 1995		
	2009	Reduktim 50 % nga niveli 1995		
	2016	Reduktim 35 % nga niveli 1995		
Mbetur. Komunale	2015	Mbledhje e ndare: letër /metal/plastik/xham		
	2020	50% riciklimi i mbet. Komunale		
Mbet e konstruktimit & Demolimit	2020	70% riciklim/pwrpunim i materialeve nga mbeturinat e konstruktimit demolimit		

Me vendosjen e raporteve ekonomike, politike me BE-, synojmë që përkrahja nga BE- për Kosovën, të rezultoj me realizimin e disa projekteve në trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, për të cilat nuk ekzistojne mundesi material dhe teknike per të u trajtuar në Kosovë.

3.3 Masat për realizimin e objektivave

Menaxhimi i mbeturinave është një ndër çështjet me interes të veçant për vendin tonë prandaj për arritjen e objektivave të kësaj strategjije janë përcaktuar masat e përgjithshme dhe të veçanta.

3.3.1 Masat e përgjithshme

- a) **Identifikimi i kërkesave dhe vlerësimi i situatës aktuale në fushën e menaxhimit të mbeturinave**

- të vazhdohet me hulumtimin sistematik të gjendjes me qëllim të fitimit të pasqyrës të përgjithshme për situatën e tanishme në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ti kushtohet vëmendje e veçantë studimit të llojeve dhe sasisë së mbeturinave të rrezikshme dhe mënyrën se si këto mbeturina administrohen, të identifikohen sasia e mbeturinave të cilat nuk janë të përfshira në sistemin ekzistues për menaxhimin e mbeturinave.
- Të përgatitet pasqyrë e detajuar e objekteve, pajisjeve dhe kapaciteteve të tyre që janë në dispozicion për administrim të mbeturinave, duke përfshirë informacionë mbi llojet dhe kapacitetet të mundshme të trajtimit të mbeturinave (në fabrika- të çimentos, të tullave, termocentrale, etj.).
- Të përgatitet raport për mbeturinat e rrezikshme që janë të magazinuara dhe që ruhen në vende të caktuara.
- Të përgatitet raport për monitorimin e gjendjes së deponive, me vlerësim të ndikimit në mjedis,
- Vazhdim i identifikimit të kërkesave për përmirësimin e gjendjes së deponive duke përfshirë mundësitë për ripërdorimin e mbeturinave apo mbylljen e deponisë.

b) Përmirësimi i sistemit të informimit për mbeturina:

- ofrimi i të gjitha resursëve të nevojshme për mbledhjen e të dhënave dhe raportimi për gjendjen e mbeturinave, duke përfshirë edukimin dhe trajnimin e të gjithë persolit që janë të obliguar për të ofruar të dhëna,
- të vazhdohet me krijimin e bazës së të dhënave siç përcaktohet me Ligj për mbeturina, baza e të dhënave duhet të jap informacione sipas nevojës për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare dhe informacione të rëndësishme në BE,
- zhvillimin i sistemit modern të informimit që do të jetë në gjendje të ofroj të dhëna të besueshme dhe në kohë, në bazë të të cilave do të jetë i mundshëm raportimi i rregullt për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave,
- përmirësimi i cilësisë, sasisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave të mbeturinave.

c) Harmonizimi i legjislacionit për mbeturina me të BE-së :

- Përgatitja e planit për harmonizimin e legjislacionit të BE-së, (sidomos sa i përket afatit kohor për realizmin e detyrave). Plani duhet të përmbajë detyrat e detajuara të pjesëmarrësve në menaxhimin e mbeturinave,
- Trajnimi i zyrtarëve në zbatimin e rregulloreve të BE-së për mbeturina.

d) Zhvillimi i sistemit për edukim, raportim dhe komunikim për menaxhimin e mbeturinave:

- Hartimi i kurrikuleve në sistemin arsimor për të mundësuar pjesëmarrjen në sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe të mbeturinave përmes programeve shkollore, përmes mediave apo punëtorive të ndryshme.
- zhvillimi i programeve dhe metodave të veçanta në arsim, informim dhe komunikim dhe zbatimit i tyre;

- inkurajimi dhe stimulimi për trajtim të mbeturinave;
- promovimi për dialog dhe partneritet me palët e interesuara (puna në grupe,) për të ndërtuar besim dhe për të arritur marrëveshje në zgjidhjen e çështjeve për menaxhimin e mbeturinave dhe zhvillimin të qëndrueshëm.

e) Kontributi në punësim:

- inkurajimi i zhvillimit të industrisë vendore dhe biznesit lidhur me shfrytëzimin e mbeturinave komunale për ripërdorim, riciklim dhe djegie me përfitim të energjisë duke stimuluar krijimin e vendeve të reja të punës,
- përkrahja e sektorit privat për menaxhimin e mbeturinave, sidomos riciklimin e tyre.
- ofrimi i mbështetjes për punë kërkimore shkencore dhe profesionale dhe inkurajimin e shoqatave profesionale në kryerjen e aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

3.3.2 Masat e veçanta

Masa 1: Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave

a) Edukimi i komunitetit, trajnimi i zyrtareve në institucione për zgjidhjen e problemeve në menaxhimin e mbeturinave

Prioritet dhe rëndësi të madhe gjithashtu do të jepet për çështjet e menaxhimit të mbeturinave në kurrikulat dhe programeve arsimore. Edhe pse deri diku subjekti i mbrojtjes së mjedisit dhe së mjedisit në përgjithësi janë ca çështje të sjellura brenda kurrikulave ekzistuese, por çështjet e menaxhimit të mbeturinave nuk i kushtohet asnjë theks i veçantë apo nuk i jepet aktualisht vëmendje për të nxitur ndryshime sociale. Qëndrimet dhe sjelljet në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në mesin e të rinjve, nxënësit dhe studentët e sotëm janë formues të nesërme të opinionit dhe vendimmarrësit. Përvoja në vende të tjera evropiane gjithashtu tregon se nxënësit dhe studentët mund të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi qëndrimet dhe sjelljet e prindërve të tyre dhe anëtarëve të tjerë të vjetër të shoqërisë.

Programe dhe aktivitete që synojnë rritjen e nivelit aktual të vetëdijes të bazuara në çasjen që përfshinë zhvillimin, hulumtimin dhe aktivitete praktike për përmirësimin e vazhdueshëm të edukimit dhe trajnimit:

- ofrimi i informatave themelore përmes mjeteve të komunikimit;
- të sigurohet një pikë kontakti publik për komunikim me qytetar në nivel lokal;
- të krijohet një ëeb faqe nga komuna me qëllim për edukim dhe informim,
- të publikohen informacione, porosi mjedisore dhe rekomandime që kanë për qëllim edukimin e qytetarëve si dhe inkurajimin për përdorimin e praktikave me të mira në menaxhimin e mbeturinave,
- krijimin e materialeve promovuese dhe edukative;
- përgatitja dhe zbatimi i fushatave promovuese për programe individuale për lloje të mbeturinave.
- bashkëpunimi me publikun, mbajtjen e komunikimit të përhershëm në mes të pjesëmarrësve.

Për ndërgjegjësimin e publikut do të duhet zhvillohen:

1. Aktivitete si:

- artikuj në gazeta
- komunikatat për shtyp
- fjalime
- paraqitjet e ftuar të stafit komunal në programet e RTV
- njoftimet shërbimit publik

2. Dhënia e leksioneve publikut duke i ftuar në:

- shkolla,
- universitete,
- në klube,
- grupet e interesit / OJQ-të,
- në ngjarje publike.

3. Faqe të thjeshtë në internet,

4. Gara dhe ekspozita,

5. Trajnimi për mirësjellje të fuqisë punëtore në fabrika dhe institucione,

6. Vizitat shtëpi më shtëpi nga vullnetar- punëtorë ndërgjegjësimit,

7. Krijimi i këshillave të fqinjëve për informacion dhe ndërtimin e komunikimit lidhur me gjendjen e shëndetësisë, mjedisit dhe mbeturinave.

Syqjerime të marrura nga: Udhëzuesi i Bankës Botërore për planifikim strategjik për menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

b) Zbatimi i projekteve dhe praktikave për prodhim të pastër

- Inkurajimi i zbatimit të projekteve dhe praktikave që përfshijnë prodhim të pastër (zvogëlimin e emisioneve nga mbeturinat) në industri dhe sektorin shërbyes duke i ofruar stimulime;

c) Fillimi i ndarjes së mbeturinave dhe riciklimi

- Krijimi i sistemeve funksionale për mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave sipas llojeve (qelq, letër, plastikë, mbeturinat nga automjetet, pajisjet elektrike dhe elektronike, gomat, metalet, kopshtet etj.), në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave komunale të hedhura në deponi sipas Objektivave në afat kohorë për administrim të mbeturinave, pika 3.2.

d) Hartimi i programeve dhe legjislacionit në përputhje me direktivat e BE-së

- Hartimi i programeve të përshtatshme dhe legjislacionit që do të rregullojnë ripërdorimin e mbeturinave të ambalazhit, konstruktimit demolimit, nga pajisjet elektrike dhe elektronike, të automjeteve dhe mbeturinave tjera të veçanta.
- Zbatimi i Ligjit për IPPC dhe lëshimi i lejeve për objektet që administrohen mbeturinat.

e) Zvogëlimi i ndikimit të mbeturinave në zona të mbrojtura

- Duhet të zbatohen masa të veçanta në zonat e mbrojtura

Masa 2: Zhvillimi i infrastrukturës për sistem të integruar të menaxhimit mbeturinave (Zvogëlim, Ripërdorim, Riciklim, Djegie, Deponim)

a) Hartimi i programeve dhe standardeve për ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve:

- Bazuar në analizën e situatës dhe qëllimet strategjike, krijimin e planit për përmirësimin e rrjetit ekzistues të pajisjeve dhe objekteve për grumbullim, ruajtje, ripërdorim, trajtim, riciklim, djegie dhe deponim të mbeturinave, caktimin e vendeve, prioritetet, zbatuesit, mënyrat e financimit dhe afatet kohore,
- Për caktimin e vendeve, ti jepet përparësi vendeve më të favorshme që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave,
- Specifikimi i kushteve dhe kërkesave për dhënien e lejeve për objektet dhe pajisjet (deponitë për mbeturina inerte, deponitë e mbeturinave komunale, magazinat e mbeturinave të rrezikshme, objektet e kompostimit etj) dhe të sigurohet monitorimi dhe kontrollimi i operimit të tyre.

b) Menaxhimi i mbeturinave të pa rrezikshme

- Planifikimi, dizajnimi dhe krijimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në nivel vendi, kryesisht për mbeturinat komunale dhe industriale të pa rrezikshme, bazuar në konsultimet në mes nivelit lokal dhe qendror,
- Në fazë të më vonshme, të zgjerohen objektet për ndarje të mbeturinave që mund të përdoren si lëndë e parë për kompostim, përfitim të biogazit etj,
- Ndërtimi i qendrave për ndarje dhe klasifikim të mbeturinave komunale,
- Zgjerimi ose përzgjedhja e lokacioneve për ndërtimin e deponive sanitare për mbeturinat komunale,
- Planifikimi i vendeve apo lokacioneve për ndërtimin e deponive për mbeturinat e konstrukt-demolimit,
- Funkcionalizimi i ligjit për ndërmarrjet publike dhe implementimi i bazës ligjore për menaxhimin e mbeturinave,
- Investimet kapitale për rehabilitim të deponive sanitare për mbeturinat komunale,
- Definimi i kompetencave dhe përgjegjësi për menaxhimin e mbeturinave komunale në nivel qendror dhe lokal,
- Mbikëqyrje dhe kontrole të vazhdueshme të sistemit për menaxhimin e mbeturinave komunale nga inspektorati komunal.

c) Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme

- Planifikimi, dizajnimi dhe ngritja e qendrës për magazinim dhe ruajtje të përkohshme të mbeturinave të rrezikshme,

- Planifikimi i disa vendeve si qendra për grumbullimin/menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme me mundësi për trajtim termik dhe fiziko-kimik në Kosovë. Vendet do të caktohen pas studimit dhe analizave gjithë përfshirëse të sasisë së mbeturinave të rrezikshme, llojet dhe mënyrat e menaxhimit, dhe pas inspektimit të secilit prej vendeve të propozuara.

Masa 3: Zvogëlimi i rrezikut nga mbeturinat

a) Përmirësimi i deponive dhe rehabilitimi i tyre

- Vazhdimi me aktivitetet sistematike që kanë për qëllim përmirësimin e deponive dhe rehabilitimin e tyre në përputhje me standardet e BE-së,
- Hartimi i legjislacionit dhe udhëzimeve për rehabilitim, në funksion të përdorimit ose mbylljes së deponive.

4. ZHVILLIMIT I KAHEVE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

4.1 Koncepti për menaxhimin e mbeturinave

Ideja kryesore dhe qëllimi i konceptit për menaxhimin e mbeturinave është të zvogëloj sasinë e mbeturinave të destinuara për deponim të përhershëm. Realizimi i konceptit të tillë do të realizohet me themelimin e sistemit të shëndoshë mjedisorë për menaxhimin e mbeturinave që do të;

- Mirëmbajtje mjedisin urban dhe shëndetin publik në të gjitha komunat,
- Motivimi i investimeve ku do të promovohet zhvillimi ekonomik secilës komunë të Kosovës.

Një sistem i shëndoshë mjedisorë i menaxhimit të mbeturinave që promovohet 3R i mbeturinave dhe zgjidhen problemet si më posht:

- **Minimizimi** i krijimit të mbeturinave, që rezulton me zvogëlimin e sasisë së mbeturinave dhe efektëve të dëmshme në vend burim të mbeturinave, në mënyrë që sasia totale e mbeturinave që administrohet, të jetë sa më e vogël,
- **Përdorimi** i mbeturinave që nuk mund të minimizohen, me qëllim të përdorimit të tyre për përfitim të energjisë, lëndës së parë sekondare varësisht nga mundësit teknike, mjedisore dhe ekonomike, kjo fazë do të filloj atëherë kur do të realizohet mbledhja e mbeturinave të ndara në lloje,
- **Riciklimi i mbeturinave** duhet inkurajuar në vazhdimsi, me qëllim që të arrihen synimet e parashikuara për riciklimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave si lëndë e parë sekondare
- Trajtimi termik i mbeturinave-shfrytëzimin e mbeturinave si lëndë djegëse dhe djegia me qëllim përfitimit të energjisë.
- **Deponimi** i mbeturinave në deponi të kontrolluara (në deponitë ekzistuese) që do të bëhet vetëm pas përpjekjeve për redukim, ripërdorim, riciklim të mbeturinave, mbeturinat grumbullohen si duhet, trajtohen sa do të jetë e përshtatshme dhe më në fund deponohen në një mënyrë të përshtatshme, pa shkaktuar ndonjë efekt negativ për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Table xx provides a simplified overview of the advantages and drawbacks of the main waste management options.

Table 9: Krahasimi i përafërt i mënyrave relative dhe të opsioneve të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve

Opcioni	Përparsitë	Mangësitë
Parandalimi	<ul style="list-style-type: none"> Ruhen burimet natyrore. Shmang nevojën për menaxhimin e mbeturinave, me qëndrueshmëri afat të gjatë. 	<ul style="list-style-type: none"> vështirësi për t'u arritur/realizuar.
Ripërdorimi dhe riciklimi	<ul style="list-style-type: none"> lejon për të maksimizuar përfitimet nga aspekti i përdorimit të materialit nga mbeturinat, Ndihmon reduktuar nevojën për nxjerrjen e materialeve. 	<ul style="list-style-type: none"> Në afat-gjata, materialet e ripërdorura dhe ricikluara përfundojnë si mbeturina, Re-përdorimi dhe riciklimi kërkojnë energji dhe gjenerojë mbeturina, Duhet të bëhet një kosto / përfitim me vlersimin për të siguruar balancën e përfitimeve (mbetet pozitiv).
Trajtimi termik	<ul style="list-style-type: none"> Shmang përdorimin e karburanteve të tjerë, zvogëlon sasinë dhe vëllimin e materialit që deponohet. 	<ul style="list-style-type: none"> Shpesh kryhet me një efikasitet të ulët, Mund të gjenerojë mbetje të rrezikshme.
Deponimi përfundimtarë	<ul style="list-style-type: none"> Nëse bëhet siç duhet, mund të zvogëlojë mundësinë që mbeturinat të shkaktojnë dëme për shëndetin e njeriut dhe për mjedisit.. 	<ul style="list-style-type: none"> Asnjë përfitim për zhvillim të qëndrueshëm, Ka një kosto të lartë.

Zhvillimi i konceptit të menaxhimit të mbeturinave do të arrihet hap pas hapi si pas vizionit të kësaj strategjie. Vitet e synuara për këtë zhvillim janë 20013 deri në 2022. Kjo periudhë kohore ndahet në dy faza:

Faza e parë 2013-2017- Ndërtimi dhe stabilizimi isistemit për menaxhimin e mbeturinave .

Faza e dytë 2018-2022- Zhvillimi i sistemit të ndërtuar për arritjen e synimeve.

4.2 Aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave të veçanta

Menaxhimi i mbeturinave të veçanta mundësohet duke u bazuar në regullativën ligjore të përafuar me standardet dhe udhëzimet e përfshira në legjislacionin e BE-së.

Këto mbeturina kryesisht mund të ripërdoren dhe riciklohen, dhe si të tilla mund të valorizohen për treg.

Do të bëhen përpjekje për të rregulluar përgjegjësitë dhe detyrimet në kornizën institucionale, me qëllim që të arrihet qëndrueshmëria financiare për menaxhimin e mbeturinave duke u

4.2.1. Mbeturinat komunale

Do të bëhen planet komunale edhe për krijimin e rrjetës së qendrave për mbledhjen dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje. Kjo do të duhet ndodhë, pasi në disa komuna sasia e mbeturinave është e vogël përshkak të numrit të vogël të banorve, atëherë ngritja e qendrave të tilla të mdha dhe të kompletuara me pajisje nuk do të kishte arsyeshmërinë, mirëpo, në këto raste mund të ngriten vetëm qendra transfer stacione për mbeturina të cila me kohe mund të rriten dhe zgjerohenvarsisht nga kërkesat.

Në kuadër të këtyre qendrave mund të grumbullohen edhe mbeturinat vëllimore, (gomat e automjeteve, orendi shtëpiake pajisje elektro shtëpiake dhe elektronikeetj), ku qytetarët mund të dorzojnë çdo ditë pune mbeturinat e tyre.

Lokacionet për qendrën grumbulluese dhe klasifikim të mbeturinave si dhe transferstacionet e mbeturinave duhet ti siguroj dhe përcaktoj komuna perkatëse.

Për të arijuar një menaxhim më të qëndrueshëm, përveq parimit “ndotësi paguan”, do të duhet gjithashtu që ndër detyrat kryesore që të minimizohet krijimi i mbeturinave dhe të bëhet trajtimi i tyre në përputhje me parimin e hierarkisë për menaxhimine mbeturinave. Për t'i arritur këto detyra duhet implementuar prioritet përmes:

a) Fuqizimit Institucional:

- Hartimi dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së,
- Miratimi i Planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe Planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave në komuna si dhe për operatorët industrial/ekonomik,
- Në Planin zhvillimor komunal me të cilin përcaktohen vendet për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave komunale,
- Krijimi i programeve edukuese vjetore për grupet me ndikim, në formë të një fushate gjithë pëfshirëse,
- Përkrahja financiare për zgjerimin e shërbimeve për mbeturinat komunale,
- Të stimulohet ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave përmes rregulloreve dhe koncesioneve,
- Të definohet përcaktimi i taksa për dhënjen e shërbimeve në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave,
- Edukimi mjedisorë dhe ngritja e edukimit mjedisorë.

b) Fuqizimit të sistemit teknik:

Për të kryer detyrat kryesore që kanë për qëllim përmirësimin e përgjithshëm të sistemit për administrim të mbeturinave duhet të merren edhe veprimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i sistemit për grumbullimin e mbeturinave komunale,
- Zgjerimi i zonave shërbyese,
- Organizimi i qendrave për menaxhimin e mbeturinave (grumbullim, trajtim, riciklim, transportim),
- Organizimi i rrjetit të transfer stacioneve,
- Organizimi i rrjetit të pikave mbledhëse për mbeturinat e veçanta dhe të rrezikshme,
- Mbyllja e deponive ilegale të mbeturinave në bazë të planit për administrim të mbeturinave,
- Përmirësimi i gjendjes së deponive ekzistuese,
- Pastrimi i hapësirave publike,
- Pastrimi i pikave ilegale,
- Ndërtimin e qendrave për kompostim të mbeturinave biodegraduese,
- Promovimi i minimizimit të mbeturinave

- Inkurajimi i përdorimit të biomasës dhe biogazit,

4.2.2. Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit

Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit do të përcaktohet sipas udhëzimeve në vijim:

- Edukimi dhe informimi i pjesëmarrsëve në procesin e menaxhimit të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit,
- Ndalimin e deponimit të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit në deponitë sanitare, në toke punuese, afër vendbanimeve, në natyrë,
- Vendosja e kontrollit të plotë mbi ciklin e mbeturinave të ndërtimit, nga vend burimi i mbeturinave deri në vend trajtim,
- Ripërdorimi i e mbeturinave të ndërtimit deri në masën 80% të sasisë totale deri në vitin 2022,
- Të inkurajohet përdorimi i materialeve ndërtimore që janë miqësore me mjedisin,
- Inspektimi i deponive të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit,
- Të hapen deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit sipas kompetencës ligjore të komunës.
- Të përcaktohet vendet për deponimin e mbeturinave që do të gjenerohen nga dekomisionimi i TC-Kosova A.

4.2.3 Mbeturinat nga industria dhe minierat

Përmirësimi e sistemit të menaxhimit të mbeturinave industriale dhe minierave do të përcaktohet sipas udhëzimeve në vijim:

- Vlerësimi i sasisë së mbeturinave sipas llojeve të mbeturinave,
- Të bëhen avancime në proceset teknologjike në mënyre që të zvogëlohen sasi të vetit e dëmshme të mbeturinave,
- Ndarjen e mbeturinave për riciklim dhe ripërdorim,
- Shfrytëzimi i mbeturinave të ndryshme nga industria,
- Të bëhet rehabilitimi i deponive industriale,
- Trajtimi ose asgjësimi i mbeturinave nga substancat kimike të rrezikshme,
- Ndërtimi i magazinave për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme,
- Eksportimi i mbeturinave me qëllim përdorimi ose asgjësimi.

4.2.4 Mbeturinat biodegraduese

Me qëllim për të paksuar mbeturinat që dërgohen në deponi dhe shfrytësimi të të gjitha mbeturinave organike të biodegradueshme si që janë mbeturinat nga fusha e agroekonomisë, industrisë ushqimore dhe përpunimit të mishit në Kosovë duhet inkurajuar për prodhimin e kompostit dhe mënyra tjera të trajtimit të mbeturinave biodegraduese për të përfutuar energjinë në forme gazi, briketi dhe lëndëve të gazta për djegie. Kërkesat për kompost në Kosovë janë të mëdha.

Subjektet kompetente do të fillojnë përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave biodegraduese në bazë të udhëzimeve:

- Inkurajimin e parandalimit ose zvogëlimit të mbeturinave biodegraduese,

- Zhvillimin e sistemit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave biodegraduese,
- Ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve për shfrytëzimin dhe përdorimin e mbeturinave biodegraduese,
- Inkurajimi i operatorve për prodhimin e kompostit nga mbeturinat e kuzhinës dhe mbeturinave tjera biodegraduese.

4.2.5 Mbeturinat e rrezikshme

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme duke:

- Krijuar organizimin e sistemit për mbledhje, grumbullim dhe transport të mbeturinave të rrezikshme,
 - Ngritur qendra për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme,
 - Zhvilluar sistem të veçantë të informimit me data bazë për mbeturina të rrezikshme,
- Përveç hierarkisë të njohur të parimeve të përgjithëshme (minimizimin e krijimit të mbeturinave, përgjegjësitë dhe detyrimet), për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, do të duhet të zbatohen instrumentet në vazhdim:
- Edukimi dhe trajnimi si dhe e drejta e publikut për qasje në informacion dhe pjesëmarrje në vendim marrje,
 - Minimizimi i sasisë së mbeturinave të rrezikshme në vend burim,
 - Eksportimi i mbeturinave shumë të rrezikshme për trajtim dhe asgjësimin e tyre
 - Stimulimi i kompanive që të zbatojnë programet e ripërdorimit dhe riciklimit.

4.2.6 Ambalazhi dhe ambalazhi mbeturinë

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të ambalazhit duke:

- Zvogëluar krijimin e mbeturinave të ambalazhit,
- Ndikuar në dizajnin e ambalazheve me qëllim të zvoglimit të mbeturinave të ambalazhit,
- Inkurajuar kompanitë për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave të ambalazhit,
- Ndalimin e deponimit të mbeturinave të caktuara të ambalazhit,
- Përcaktuar taksë për mbeturina për prodhuesit dhe importuesit, me qëllim që të krijohen fonde të nevojshme për mbrojtjen e mjedisin (mbledhjen, klasifikimin në lloje, ripërdorimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave të ambalazhit).



Një Qendër për mbledhjen dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje.

4.2.7 Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të automjeteve mbeturinë duke:

- Përcaktuar taksë për importin dhe prodhimin e automjeteve për të mbuluar koston e menaxhimit/ trajtimit të tyre pasi të bëhen mbeturinë,
- Inkurjuar qytetarët dhe pronarët që në fund të jetës së automjeteve të tyre, ato ti sjellin në pikat e grumbullimit ose çmontimit,
- Organizuar sistemin për grumbullimin dhe transportimin e automjeteve mbeturinë deri në vendet e trajtimit,
- Sistemin e menaxhimit të automjeteve mbeturinë do të përfshinë edhe mbeturinat e mjeteve hekurudhore dhe të aeroplanëve,
- Inkurajuar ripërdorimin e pjesëve funksionale të automjeteve mbeturinë.

4.2.8 Gomat mbeturinë

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të gomës duke:

- Përcaktuar taksë të veçantë për importin dhe prodhimin e gomave për të mbuluar koston e menaxhimit dhe trajtimit të tyre, pasi të bëhen mbeturinë,
- Inkurajuar ripërdorimin e gomave të veçanta të përdorura,
- mundësuar trajtimin termik të kontrolluar, kur mbeturinat e gomave nuk mund të trajtohen ndryshe (prodhimin e energjisë, konvertimit në gaz sintetik ose në vaj).

Në mënyrë që të japet një nxitje për riciklimin e gomave në Republikën e Kosovës, do të duhet që përmes një kontributi për mjedis (do të duhet rregulluar dispozitën ligjore) që konsumatori të paguaj një EKO- Kontribut për çdo gomë të re ose të vjetër që importohen.

Aktualisht nuk ekziston një kompani në Kosovë e cila ka investuar në makineri për

grirjen e gomave dhe për të ndarë gomën, çelikun dhe tekstilet. Metali mund të eksportohet për riciklimin. Goma e grirë në copa apo pluhur gome e cila mund të eksportohet, ose do të përpunohet në produkte të ndryshme gome si mbushës/shtesë për asfalt etj. Textili mund të shkojë në deponi të mbeturinave komunale ose të digjet në furrat industriale. Për një projekt i tillë do të ishte i zgjidhje e duhur për mbeturinat e gomave. Kapaciteti i fabrikës duhet harmonizuar në ato kapacitete që mund të riciklojnë gomat të cilat krijohen mbeturinë në Kosovë. Krijimi i sistemit për grumbullimin dhe transportin e gomave të përdorura do të duhet të përkrahët nga MMPH.

4.2.9 Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike

Të krijohet sistemi i qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike që do të rezultojë në mbledhjen e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike duke:

- grumbulluar dhe transportuar mbeturina nga pajisjet elektrike dhe elektronike në qendrat grumbulluese dhe demontuese për këto lloje të mbeturinave
- Inkurajuar operatorët që të bëjnë ndarjen, ripërdorimi dhe riciklimi mbeturinave,
- eksportuar mbeturina nga pajisjet elektrike dhe elektronike në rast se nuk mund të trajtohen në Kosovë.
- Inkurajuar për zbrazen dhe ruajtjen, si dhe trajtimin e duhur të komponentave që përbajnë substanca të qëndrueshme të dëmshme.

4.2.10 Mbeturinat nga përpunimi i ujërave të zeza

Llumi nga përpunimi i ujërave të zeza do të administrohet në pajtim me praktikën e BE-së. Në Kosovë që nga viti 2012 do të krijohet llum nga ipijanti për trajtimin e ujërave të zeza për qytetin e Skenderajt.

Llumi i krijuar në impiantët për trajtimin (25%) e ujërave të zeza mund të përdoret për qëllime të :

1. bujqësisë,
2. kompostim,
3. djegia në fabrikën e çimentos, termocentraleve etj.,
4. mbulim të deponive të mbeturinave.

Sasia e pergjithëshme e llymit që mund të krijohet nga ujrata zeza në Kosovë, bazuar në të dhënat më të mira të mundshme, (totali i shkarkimit të ujërave të zeza në 2004-tën në Kosovë është rreth 1,200 l/s , apo 110,000 m³/d), është 25,700m³ /d.

4.2.11 Mbeturinat e kafshëve dhe nga industria e ushqimit dhe përpunimit të mishit

Pasi që nuk ekzistojnë të dhënat për këto mbeturina është e nevojshme që të bëhet një studim me të cilin do të definohen burimet e këtyre mbeturinave, sasinë e mbeturinave, jepen propozimet për

mënyrën e menaxhimit dhe propozimi për mikrolokacionet për varrimin dhe asgjësimin e këtyre mbeturinave .

Të ngritën kapacitete teknike për trajtimin e mbeturinave të kafshëve nga proceset e therjes dhe të mbeturinave të kafshëve të ngordhura.

Të bashkëpunohet me MBPZHR, Agjensionin e Vetërinarisë dhe Ushqimit të Kosovës për realizimin e projektit të binjakzimit për ngritjen e fabrikës për përpunimin e mbeturinave gjatë therjes së shtazëve, shpezve, mbeturinat si ngordhësit dhe mbeturinat nga industria e ushqimit dhe përpunimit të mishit.

Tani është në realizim esipër projekti i për ngritjen e impiantit për trajtimin e mbeturinave nga përpunimi i mishit, të cilin projekt po e financon Komisioni Evropian përmes mekanizmit të binjakzimit.

4.2.12 Vajrat e përdorura mbeturinë

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturina të vajrave:

- Inkurajimi për riciklimin e vajrave mbeturinë (minerale dhe ushqimore),
- Trajtimi i kontrolluar termik të vajrave mbeturinë në fabrikat ekzistuese,
- Përcaktimi i taksës së veçantë për prodhimet e vajrave dhe importit të tyre, për të mbuluar koston për trajtimin e mbeturinave të tyre,
- Përmirësimin e sistemit për mbledhjen e ndarë të vajrave të përdorura në çdo Komunë,
- Të inkurajohen fabrikat për djegie të vajrave mbeturinë me qëllim të përfitimit të energjisë, apo në rritjen e kapaciteteve ekzistuese,
- Mbledhja e vajit ndaras sipas llojeve për qëllim ripërdorimi dhe riciklimi.

4.2.13. Mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar duke:

- Ndaluar shitjen e baterive me përmbajtje të metaleve të rënda, Mercuri dhe kadmiumi,
- Promovimin e riciklimit të akumulatorve të Pb në pajisjet e ngritura ne Kosovë.
- Përcaktuar taksë të veçantë për import dhe prodhim, për të mbuluar koston për trajtimin e mbeturinave të tyre,
- Krijuar sistemin për administrim të mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar.

Në këtë aspekt është e nevojsh me:

- inkurajimi i konsumatorëve të dorëzojnë bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar në pikat grumbulluese,
- inkurajimin për përdorimin e baterive rimbushëse përmes politikave financiare dhe tatimore.
- inkurajimi i eksportit të baterive, për të cilat nuk ekzistojnë kushte për trajtimin e tyre në Kosovë.

4.2.16. Mbeturinat medicinale

Nuk është e ditur se është bërë ndonjë matje për sasinë e krijuar të mbeturinave spitalore.

Bazuar në përvojat e shteteve tjera , supozohet se në ditë institucionet spitalore publike krijojnë mbeturina afërsisht 2kg për krevat (75 - 90%- *Mbeturina inerte*) . Në këtë sasi janë të përfshira mbeturinat që janë të ngjashme me ato komunale (Shtëpiake , nga pastrimet, dhe nga administrate) dhe mbeturinat e pastërta medicinale (që mund të jet mbeturinë jo të rrezikshme dhe mbeturina të rrezikshme). Mbeturinat e rrezikshme medicinale mund të jenë infektive, anatomike, citostatik, toksik etj.

Vlersimi për krijimin e mbeturinave medicinale (10%-25%) është e bazuar ne këto supozime:

- Mbeturinat medicinale 0.6 kg /krevat/ ditë .
- Mbeturinat e rrezikshme medicinale 0.2-0.8 kg/ krevat/ ditë.

Kapaciteti i krevateve në spitalet publike të Kosovës janë 4065 krevate.

Supozohet se në sektorin privat ekzistonë rreth 10% e numrit të krevateve të sektorit public.

Tabela 10. Sasinë e mbeturinave spitalore të gjeneruara në Republikën e Kosovës

Loji I mbeturinave	Nr. i krevateve	Sasia e mbeturinave kg/krevat/ditë	Sasia e mbeturinave	
			kg/ditë	t/vit
Materijale që mund të riciklohen	4,472	1,2	6,439	2,350
Mbeturinat medicinale	4,472	0,6	2,683	979
Mbeturinat e rrezikshme medicinale	4,472	0,2	894	326
Gjithsejt			10,016	3,655

- Të krijohet sistemi për menaxhimin e mbeturinave medicinale,
- Të trajnohet stafi medicinal-profesional për zbatimin e standardeve të BE-së për menaxhimin e mbeturinave,
- Të ndërtohen impiantet për menaxhimin e mbeturinave medicinale në veçanti ato infektive.

5. VLERËSIMI I INVESTIMEVE DHE BURIMI I MJETEVE FINANCIARE

Vlerësimi i nevojave financiare për zbatimin e Strategjisë, si dhe burimet e financimit për menaxhimin e mbeturinave do të jenë kryesisht sipas parimit „ndotësi paguan”. Përveq taksave që do të vjelen për dhënien e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave komunale, mjete financiare për rrealizimin e projekteve të ndryshme do të shfrytëzohen nga buxheti Republikës së Kosovës, buxheti i komunave, nga donacionet e ndryshme si dhe nga futja në funksion e instrumenteve ekonomike, si që janë taksat në importe, në produkte, taksa në shërbime tjera.

Planifikimi duhet të bëhet në funksion të ndryshimeve të mëdha dhe investimet që do të jenë të nevojshme për të zbatuar këtë strategji, si edhe për të plotësuar disa nga kërkesat

e legjislacionit ekzistues vendorë dhe Europian (në veçanti Direktivën për deponi). Horizonti i planifikimit për ngritjen dhe funksionalizimin e objekteve për menaxhimin e mbeturinave dhe dhënies së shërbimeve duhet mbulojë një periudhë të përcaktuar prej 10 vjetësh (2013-2022).

Shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave të hedhura nga amvisritë, bizneset dhe institucionet kryesisht mbullohen nga kostoja e kalkuluar për marrjen/dhënien e shërbimit për mbledhjen, bartjen dhe deponimin e mbeturinave komunale.

Mjetet e nevojshme për realizimin e Strategjisë përfshijnë mjetet financiare për ngritjen e infrastrukturës për sistemin për menaxhimin e mbeturinave dhe mjetet për mbullimin e shpenzimeve për operim.

Vlersimi i mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e projekteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës për periudhën 2013 - 2022 është treguar në specifikimet që vijojnë:

A) Kostoja e vlerësuar për veprimet e planifikuara

1. Masat e përgjithëshme

- Studimi i fizibilitetit për hartimin dhe krijimin e instrumenteve ekonomike edhe lidhur me menaxhimin e mbeturinave i rekomandimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave. (nivel republikës së Kosovës);
- Hartimi i Planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave nga komunat;
- Krijimin e programit për menaxhimin e llojeve të caktuara të mbeturinave;
- Krijimin e sistemit të informimit për menaxhimin e mbeturinave;
- Hartimi i kompletimi i legjislacionit për mbeturina në përputhje me acquis të BE.

Kostoja e kalkuluar: € 2.0 mln

2. Zvogëlimi i krijimit të mbeturinave

- Zhvillimi i Kurikuleve dhe programeve të edukimit mjedisor lidhur me mbeturit për të gjitha nivelet (kopshtet, shkollat, kolegjet, universitetet)
- Inkurajimi i prodhimit të produkteve ekologjike dhe konsumit të tyre (largimi i qeseve PE, prodhimi dhe përdorimi i materialeve të degradueshme);
- Zvogëlimi i sasisë së ambalazheve për paketimin e mallrave të prodhuara.

Kostoja e kalkuluar € 3.0 mln

3. Rrjeta e qendrave për menaxhimin -Trajtimin e mbeturinave të biodegradueshme

- Mbeturinat e biodegradueshme prodhimin e kompostit;
- Nritja e impijantit për trajtimin e mbeturinave nga therrja e kafshëve dhe përpunimi i mishrave;
- Mbeturinat e biodegradueshme Prodhimin e gazit;
- Mbeturinat e biodegradueshme Prodhimin briketit (pelet);

Kostoja e kalkuluar € 8.2 mln

4. Makineri dhe pajisje për mbledhjen e mbeturinave

- Blerja e kamionëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale,
- Blerja e kontejnerve të ndryshëm për mbeturinat komunale,
- Blerja dhe vendosja e enëve të ndryshme për vendosjen e mbeturinave veçanta dhe të rrezikshme.

Kostoja e kalkuluar € 25.0 mln

5. Rrjeta e Qendrave për grumbullimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje

- Ngritja e 20 -transfer stacioneve dhe qendrave për pranimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje.

Kostoja e kalkuluar € 10.0 mil

6. Ndërtimi i qendres për trajtimin e mbeturinave komunale

- Impiantet për ndarje dhe trajtimin të mbeturinave komunale (në lokacionet e deponive komunale

Kostoja e kalkuluar € 30.0 mil

7. Zgjerimi i deponive sanitare dhe mirëmbajtja e tyre

- Zgjerimi i hapësirën deponim në deponisë në Sharr;
- Ndërtimi i deponisë së re ose zgjerimi i deponisë ekzistuese në regjionin e Pejës;
- Studimi dhe hulumtimi i gjendjes së deponisë Regjionale në Mitrovicë.

Kostoja e kalkuluar € 4.15 mln

8. Përmirësimin e gjendjes në deponi

- Përmirësimi i gjendjes teknike në deponine e regjionit te Prishtinës – Obiliq;
- Përmirësimi i menaxhimit të deponive të mbeturinave komunale dhe trajtimi i ujrave të ndotura të deponi-Landovicë, Gjilan, Podujevë, Prishtinë.

Kostoja e kalkuluar € 5,5 mln

Total 3-8 (Mbeturinat komunale) € 87.85mil

9. Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme

- Pastrimi i mbeturinave dhe tretjeve kimike nga ish Industria metalike –Pejë;
- Pastrimi i lumit Lepec ga mbeturinat e azbestit –Hani i Elezit;
- Pastrimi i mbeturinave nga Industria e tektilit – ish Shartex- Sharr;
- Trajtimi i pesticideve te holluara – në deponinë e mbet. Podujeve;

- Pastrimi i mbeturinave nga Industria e tekstit- ish Emin Durak- Gjakovë;
- Mbeturinat e Fabrikës së akumulatori Pejë;
- Mbeturinat e nga ish Fabrika e lëkurë këpucëve Pejë;
- Mbeturinat nga Fabrika e baterive – Gjilan;
- Shkatërrimi i mbeturinave me PCB/PCT.

Kostoja e kalkuluar € 7.0 mil

10. Rrjetën e Qendrave për mbledhjen e mbeturinave nga konstruktimi-demolimi i objekteve ndërtimore

- Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave 12-qendrave për trajtimin e mbeturinave nga konstruktim demolimit i objekteve ndërtimore.

Kostoja e kalkuluar € 9.0 mln

11. Eliminimi i deponive ilegale dhe vendeve të ndotura

- Pastrimi i vendeve me mbeturina nga hudhja ilegale në komunat e Kosovës.

Kostoja e kalkuluar € 10.0 mln

12. Rehabilitimi i vendeve të ndotura me mbeturina industriale dhe të minierave

- Pastrimi i vendeve të kontaminuara me kimikate industriale dhe në miniera

Kostoja e kalkuluar € 20.0 mln

Total 9-12 **€ 46.0 mln**

Investimi total i nevojshëm është llogaritur 133.85 milion euro, të cilat janë të destinuara sipas strukturës të paraqitur më lartë.

B) Financimi i Strategjisë (2013 - 2022)

Të gjitha burimet e financimit duhen të përcaktohen që të mundësojnë realizimin efikas të projekteve të planifikuara në kuadër të sistemit për menaxhimin e mbeturinave. Jo më shumë se gjysma e fondeve të përgjithshme do të sigurohen nga të ardhurat publike, pjesa tjetër do të sigurohet nga burime tjera.

Për shkak të çmimeve relativisht të ulëta të taksave për shërbimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave, do të jetë shumë me rëndësi që të planifikohet rritja e tyre graduale dhe e vazhdueshme për të mbuluar kostot reale në këtë sektor.

Veprimet kryesore të nevojshme për zbatimin e Strategjisë dhe agjencitë udhëheqëse të përfshira me afatet eptwr zhvillimin e projekteve, janë përmbledhur më poshtë në tabelën 11. Ato përbëjnë thelbin e Strategjisë, së bashku me Planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave.

Plani i financimit për realizimin e Strategjisw do të varet nga burimet si vijon:

- **Burimet qeveritare** - të ardhurat nga pushteti qendror, burimet e qeverisjes Komunale, pagesat për shërbimet publike, tarifa të tjera për mjedisin dhe taksat mjedisore;

Mbështetja e sektorit privat - p.sh. financimi nga industria për shpenzimet e tyre të ndotjes, dhe partneritetit publiko-privat për të financuar infrastrukturën e mjedisit dhe të shërbimeve;

- **Financimi ndërkombëtar** - huamarrja nga bankat jashtë shtetit, kreditë dhe grantet nga donatorët OQ dhe OJQ-ve ndërkombëtare dhe, si dhe huave nga agjencitë për zhvillim ndërkombëtar.

Pa marrë parasysh se sa e vështirë do të jetë vendim-marrja, nuk ka largim nga fakti se projektet në zonat me probleme kritike për mjedisin do të marrin investime disa-milionëshe. Është e ditur se fondet e tilla janë të kufizuara për çdo vend në tranzicion siç është Republika e Kosovës. Edhe pse kjo në shikim të parë mund të duket e frikshme për burimet e financimit, duhet të mbahet mend se këto janë investime kritike/domosdoshme dhe duhet të bëhet në një fazë, derisa Kosova do të përmbushë Rregulloret e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mjedisore.

Jo më shumë së gjysma e fondeve të përgjithshme do të sigurohen nga të ardhurat publike, pjesa tjetër do të sigurohet nga burime tjera.

Për shkak të çmimeve relativisht të ulëta të taksave për shërbimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave, do të jetë shumë me rëndësi që të planifikohet rritja e tyre graduale dhe e vazhdueshme për të mbuluar kostot reale në këtë sektor.

Vlerësimi i shpenzimeve bëhet që të sigurojë një tregues të madhësisë së investimeve të nevojshme në periudhën afatmesëm dhe afatgjatë. Kjo strategji nuk ka marrë parasysh kriteret për "gatishmërinë për të paguar" gjithashtu edhe "aftësinë për të paguar", këto do të vendosen në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Realizimi i projekteve sipas kësaj strategjie është përmbledhur në këto objektiva:

Objektivi 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave;

Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturën për mbeturina;

Objektivi 3: Rritja e shkallës së vetëdijsimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit

Tabelën: 11- Realizimi i projekteve sipas investimeve dhe të agjencive udhëheqëse për zbatim dhe kostot e projekteve

Objektivi 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave					
Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë					
Objektivi 3: Rritja e e shkalës së vetëdijimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit					
Nr. / Masat	Qëllimi i investimeve (sipas A)- Veprimet	Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore	Kostoja e vlerësuar [€]	Burimet e sugjeruara
1. Trajtimi - Infrastrukturë	Rrjeti i qendrave për mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave nga konstruktim demolimit, (10)	Qeveria MMPH Komunat	2014-2017 2018-2022	4,5mln 4,5mln 9,0 mln €	40%,Donatorët 30% BK 30% komunal
2. Deponim infrastrukturë	Zgjerimi i deponive sanitare dhe mirëmbajtja e tyre(7)	Qeveria MMPH Komunat	2014-2016 2017-2020	€ 3.5mil 0.65mil 4.15 mln	30% Donator 70% BK
3. Trajtimi dhe Infrastrukturë	Rrjeti i qendrave për menaxhimin - trajtimin e mbeturinave të biodegradueshme(3)	Qeveria AVUK MMPH	2013-2017 2018-2022	€ 3.5mln 4.7 mln 8.2 mln	80% Donator 20% BK
4. Menaxhimi Infrastrukturë	Përmirësimi i gjendjes së deponive komunale të mbeturinave(8)	MZHE MMPH KMDK	2014-2017 2018-2019	€ 4,0 mln 1.5 mln 5,5mln	70% Donator 30% BK
5. Mbledhje- Infrastrukturë	Furnizimet me makineri dhe pajisje për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale(4)	Qeveria MPL Komunat	2013- 2017 2018-2022	€ 6.5mln 18.5 mln 25.0mil	50% Donator 30% Komuna 20% BK
6. Menaxhim redukim mbeturinave	Eliminimi i deponive ilegale dhe vendeve të ndotura pastrimi i vendeve me mbeturina nga hudhja ilegale në komunat e Kosovës (11)	Qeveria MPL Komunat	2013-2017 2018-2022	€ 5.0 mln 5.0 mln 10.0 mln	80%Komuna 20%BK

7. Trajtimi dhe Infrastrukturë	Ndërtimi i qendrës për trajtimin e mbeturinave (6)	Qeveria Komuna MPL	2018-2022	30.0 mln	70% Donator 30% BK
8. Mbledhje-infrastrukturë	Rrjeta e qendrave (TS) për grumbullimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje (5)	Qeveria Komuna MPL	2013-2016 2018 -2022	€2.0 mln 8.0 mln 10.0 mln	40% Donator 30% BK 30% Komuna
9 . Edukim vetëdijsim, ndërgjegjësim	Zvoglimi i krijimit të mbeturinave (2)	Komuna MMPH MASHT	2013- 2019	3,0mln	80% BK 20% Komuna
10. Krijimi i sistemit planifikim , legjislacion	Masat e përgjithshme (1)	MMPH Komuna	2013- 2016	2,0 mln	50% BK 50% Komuna
11. Menaxhim pastrim , trajtim	Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme (9)	Qeveria APK MZHE MMPH	2015-2022	7.0 mln	20% BK 80% APK
12. Menaxhim pastrim , trajtim, rehabilitim	Rehabilitimi i vendeve të ndotura me mbeturina industriale dhe të minierave(12)	Qeveria APK MZHE MMPH)	2015- 2019	20.0 mln	10% BK 20% Donator 70% APK
Kostoja totale				€133.85 mln	

Tabela: 12- Shpërndarja e investimeve për Dhjetë (10) vite dhe për dy (2) periudha

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022

Viti	Periudha -I					Periudha -II					Nr.ren. Kap. 5A kg/periudh I+II	Burimi i sygjeruar i financimit		
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022		BK [kg]	Kom/APK [kg]	Donat. [kg]
Investimi [€]		0.50	0.50	0.50	0.50	-	-	-	-	-	1- 2.0	1.0	1.0/-	-
	0.30	0.50	0.50	0.50	0.50	0.20	0.50	-	-	-	2- 3.0	2.4	0.6/-	-
	0.70	0.70	0.70	0.70	0.70	0.94	0.94	0.94	0.94	0.94	3- 3.5+4.7	1.64	-/-	6.57
	1.30	1.30	1.30	1.30	1.30	3.70	3.70	3.70	3.70	3.70	4- 6.5+18.5	5.0	7.5/-	12.5
	-	0.50	0.50	0.50	0.50	1.60	1.60	1.60	1.60	1.60	5- 2.0+8	3.0	3.0/-	4.0
	-	-	-	-	-	6.0	6.0	6.0	6.0	6.0	6- 30	9.0	-/-	21.0
	-	1.1666	1.1666	1.1666	0.1625	0.1625	0.1625	0.1625	-	-	7- 3.4998+0.65	2.905	-/-	1.245
	-	1.0	1.0	1.0	1.0	0.75	0.75	-	-	-	8- 4.0+1.5	1.65	-/-	3.85
	-	-	0.875	0.875	0.875	0.875	0.875	0.875	0.875	0.875	9- 7.0	1.4	-/5.6	-
	-	1.125	1.125	1.125	1.125	0.90	0.90	0.90	0.90	0.90	10- 4.5+4.5	2.7	2.7/-	3.6
	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	11- 10.0	2.0	8.0/-	-
-	-	2.50	2.50	2.50	2.50	2.50	2.50	2.50	2.50	12- 20.0	2.0	-/14	4.0	
Investimi/vite [€]	3.30	7,7916	11.1666	11.1666	10.1625	18.6275	18.92275	17.6775	17.515	17.515	Gjitsej	34.695	22.80/19.60	56.765
Investimi /periudh I/II [€]	43.5873 mln. (32.56%)					90.25775 mln. (67.44%)					Total	133.85 mln.		
Totali [€]	~133.85 mln.											25.92%	(17.20/14.64) %	42.24%

6. PËRFUNDIMET

Strategjia për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës është bazuar në parimet e përgjithshme të menaxhimit të mbeturinave në BE-së, dhe është kornizë për zbatimin e përvojave më të mira në menaxhimin e mbeturinave.

Bazuar në qëllimet dhe masat, është propozuar koncepti për; zvoglimin, përdorimi, riciklimi dhe deponimin e mbeturinave. Disa programe janë propozuar edhe për mbeturinat e rrezikshme, sidomos për mbeturinat e veçanta.

Vizioni për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, është i bazuar në:

- një qasje të integruar për menaxhimin e mbeturinave;
- organizimin e qendrave për menaxhimin e mbeturinave, ndërtimi i impianteve për trajtimin e mbeturinave dhe menaxhimin e drejt të deponive ekzistuese,
- asgjësimin e sigurt të mbetjeve që nuk mund të menaxhohet ndryshe,
- rritja e riciklimit dhe kompostimi;
- një reduktim i sasisë së mbeturinave të rrezikshme,
- mbrojtjen e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mbeturinat,
- monitorimin dhe kontrollin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave,
- angazhimin e kapitalit të nga shtetet e jashtëme për menaxhimin e mbeturinave,
- edukimin e publikut, trajnimi i zyrtarve me qëllim të ngritjes së nivelit të njohurive për menaxhimin e mbeturinave.
- pjesëmarrja më e madhe e publikut në procesin e vendimmarrjes.

Mjetet e nevojshme financiare për realizimin e Strategjisë gjatë 10 viteve të ardhëshme, është vlerësuar të jetë 133.85 milion euro. Burimet e financimit të planifikuar për këtë qëllim janë: Buxheti i Republikës së Kosovës 25.92% bugjetet komunale 17.20%, si dhe donacione të jashtme 42.24%, si dhe burime tjera 14.64% psh APK.

Në pajtim me nënin 9 të Ligjit për Mbeturina dhe bazuar në këtë Strategji si dhe në përputhje me praktikën e BE-së, Qeveria e Republikës së Kosovës do të miratojë Planin e Menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Miratimi i Strategjisë dhe Planit për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës është me rëndësi të veçantë pasi që këto dokumente do të ndikojnë në zgjidhjen e vazhdueshme të problemeve aktuale dhe përmirësimin e sistemit të tanishëm, drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave.

Miratimi i kësaj strategjie bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Lista e ekspetrëve

1. Agron Veliu, Neë Co Ferronikeli
2. Ahmet Ahmeti, MMPH
3. Albana Hajrizi, DMM-MMPH
4. Avni Ramadani, KMDK
5. Asllan Vitaku, fak. Xehtaros Metalurgjik -Mitrovicë
6. Bajram Kadriu, DMM-MMPH
7. Bajram Isufi, KRM "Higjena"
8. Driton Vatovci, GIZ
9. Enver Tahiri, DMM-MMPH
10. Florije Tahiri, DMM-MMPH
11. Fatlum Berisha, Dogana e Kosovës
12. Hazir Çadraku, MMPH
13. Halil Berisha, Sharrcem
14. Ibrahim Balaj, DMM-MMPH
15. Idriz Gashi, MBPZHR
16. Ilir Morina, AMMK
17. Isuf Zeneli, MAPL
18. Ismajl Shurdhaj, AKPM
19. Lindit Sopaj, DMM-MMPH
20. Leonora Durmishi, MMPH
21. Mejreme Cernobregu, ZRRUM
22. Milaim Sadiku, Trepça
23. Mimoza Hyseni AMMK
24. Musa Riza, FXM- Mitrovicë
25. Naser Afizi, MMPH
26. Nexhat Abdullahu, KRM "Ambienti"
27. Osman Leci, FSHMN
28. Ramadan Uka, OJQ "Eko-Trepça"
29. Ramadan Tafallari, KK Prizren
30. Remzi Sylejmani, MEF
31. Rustem Abiti, KRM "Unitëti
32. Safet Osmani, MPB,
33. Sami Hasani, ZRRUM
34. Sabri Kadriu, KRM "Pastrimi"
35. Selvetë Gashi, OJQ "Lulebora"
36. Shaban Veseli, KRM "Ekoregjioni"
37. Shaqir Ukshini, KK Gjilan
38. Shqipe Arifaj, AKK
39. Tafë Veselaj, AMMK
40. Valmira Gashi, MMPH
41. Xhemajl Sejdiu, KEK
42. Zeqir Veselaj, REC
43. Zeqirjahja Hyseni, KEK